**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar"**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Barleti"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1.Prof.Asoc. Ariana Bejleri

2.Prof.Asoc. Valma Prifti

Korrik 2023

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**
**Për Programin e studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Barleti"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Barleti |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK) |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Programin i studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhri Nr. 549, date 11/11/2011, prot nr 5927. |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdher nr 99 dt 20.03.2012 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | Urdhri i MASH nr 350, date 21.09.2015, me kohezgjatje 6 vite. |
| 8 | Cikli i studimit: | Program i ciklit te pare te studimeve |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2022-2023 PAE 75%<br>2021-2022 PAE 70%<br>2020-2021 PAE 77% |
| 18 | Numri i studentëve: | 2022-2023 72 st<br>2021-2022 34 st<br>2021-2021 20 st |
| 19 | Komente / të tjera: | |

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i pajis të diplomuarit me njohuri mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme në fushën e informatikes dhe teknologjise se informacionit duke mundësuar një njohje të mirë të koncepteve rreth teknologjive bashkëkohore. Programi mundëson studimin e gjuhëve bazë të programimit, sistemeve të informacionit dhe teknologjive të reja.

Ky program përgatit profesionistë të ardhshëm për kompanitë dhe institucionet, për zgjidhje të problemeve të ndryshme duke aplikuar teknologjive bashkëkohore. Gjithashtu menaxhimin e tyre dhe marrjen e vendime efektive. Studentët pajisen me aftësi praktike të programimit dhe të organizimit të sistemeve të informacionit. Gjithashtu ata marrin njohuri për të vlerësuar efektivitetin e sistemeve në proceset e biznesit. Studentët marrin aftësi lidhur me zhvillimin e projekteve teknologjike të biznesit, Internet of Things, sistemet embedded, analizën e të dhënave etj.

Studentet e diplomuar në programin e studimit "Informatikë e aplikuar", punësohen si: Analist i Sigurisë së Informacionit, Zhvillues softueri, Specialist në informatike, Zhvillues web-i, Administratori për bazën e të dhënave, Analist i Sistemeve Kompjuterike, Arkitekt i Rrjetit Kompjuterik, etj.

Programi i ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar' është program i ciklit të parë të studimeve, i licensuar me urdhrin Nr. 549, datë 11/11/2011, prot. nr 5927, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ai ofrohet nga Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK), në Fakultetit të Shkencave te Aplikuara dhe Industrive Kreative.

Ky program i nënshtruar procedurës së akreditimit 1 herë, me urdhrin e MASH, nr. 350, datë 21.09.2015 dhe me kohëzgjatje 6 vite.

Ky është procesi i akreditimit për herë të dytë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

### Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), nga ASCAL është ngritur Grupi i Vlerësimit të Jashtëm me qëllim akreditimin e Programit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar'. Anëtarët e GVJ janë zgjedhur në bazë të kompetencave të tyre profesionale, paanshmërisë, mundësisë për të aksesuar, mbledhur dhe përpunuar informacionin e nevojshëm për kryerjen e vlerësimit duke marrë në konsideratë mendimet e tyre.
GVJ përbëhet nga 2 anëtarë dhe është themeluar për qëllim të raportit të vlerësimit të jashtëm të Programit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar'.
Procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar' është realizuar nga GVJ në bashkëpunim me ASCAL.
Gjithashtu gjatë procesit është përfshirë edhe një vizitë në institucion.
Aktivitetet e kryera në kuadër të hartimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtem të Programit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar'nga GVJ janë zhvilluar në bazë të afateve kohore të përcaktuara më parë.
Gjatë kryerjes së procesit, GVJ është udhëhequr nga ruajtja e etikës profesionale dhe zbatimi i kuadrit ligjor mbi aksesin në të dhënat personale dhe konfidencialitetin e tyre.
Procedura e vlerësimit të jashtëm, është parë si një proces dinamik vlërësimi dhe diskutimi për të paraqitur realitetin dhe njëkohësisht të evidentohen dhe adresohen për zgjidhje problematikat e mundshme.
Në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Programit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" është synuar të jepet një tablo e qartë gjithëpërfshirëse për programin e studimit, duke evidentuar njëkohësisht cilat janë pikat e forta të këtij programi studimi dhe ato që duhen përmirësuar në të ardhmen.
Për realizimin e këtij raporti, GVJ u mbështet në të gjitha dokumentat e nevojshme të prodhuara nga Institucioni në dosjen e vetëvlerësimit të zhvilluar nga Universiteti Barleti, në kuadrin e akreditimit të Programit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar'.
Gjithashtu GVJ u bazua në kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe në dokumenta të veçanta si "Manuali i vlerësimit institucional të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri", i përgatitur nga ASCAL.
GVJ e ka organizuar punën e tij duke ndarë detyrat për të mundësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse njohjen dhe evidentimin e dokumentave dhe realizimin e raportit.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

**I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.350, datë 21.09.2015 janë:**

1. Pasurimin e bibliotekës me tituj për këtë program studimi;
2. Rritjen e cilësisë të studentëve në hyrje
3. Mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm, veçanërisht të stafit të ri akademik të angazhuar në këtë program.

**II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**

1. Në lidhje me rekomandimin e parë, Departamenti në bashkëpunim të ngushtë edhe me bibliotekën e UniBa, çdo vit bën një analizë të literaturës që gjendet në UniBa duke bërë përditësime të kësaj të fundit jo vetëm në lieraturë fizike, por edhe elektronike. Konkretisht në fondin e bibliotekës së UniBa-s gjenden 37 tituj librash të cilët iu vijnë në ndihmë si studentëve po ashtu edhe pedagogëve për literaturën bazë dhe atë të rekomanduar dhe që i përkasin fushës së teknologjisë së informacionit. 25 prej këtyre titujve janë shtuar vetëm përgjatë vitit 2022. Në bibliotekën dixhitale **EconBiz**, bibliotekë që ofron orientim dhe ndihmë në kërkimin e artikujve, punimeve dhe librave dixhital si dhe akses të plotë e të licensuar në internet për materialet që ofron, universiteti Barleti ka një marrëveshje bashkëpunimi prej disa vitesh. Tjetër bibliotekë dixhitale me të cilën universiteti Barleti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi është **Research4life**, bibliotekë që u ka ofruar studiuesve të 10,500 institucioneve në mbi 125 vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme qasje falas ose me kosto të ulët aksesim në biblioteka online deri në 151,000 revista dhe libra kryesorë në fushat e shëndetësisë, bujqësisë, mjedisit, shkencave të aplikuara dhe informacion ligjor. Një tjetër bibliotekë digjitale, që studentët e pedagogët kanë akses, duke përdorur llogarinë e bibliotekës së Universitetit, është ''Jstor'' e cila siguron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore në 75 disiplina. Universiteti Barleti aktualisht ka abonim me llogarinë e bibliotekës, nëpërmjet të cilës, mund të aksesojnë stafi akademik dhe studentët dhe është i mundur leximi online dhe ruajtja e materialeve që kërkojnë direkt nga platforma e tyre. Me këtë bibliotekë universiteti "Barleti" ka një marrëveshje për një periudhë 1-vjecare për ofrimin e aksesimit "të hapur" dhe të shkarkimit në të gjithë artikujt shkencorë.

   Të tjera burime në të cilat mund të gjenden artikuj, libra, revista shkencore, punime doktorale janë, **Open Textbook Library,** bibliotekë e hapur e teksteve shkollore, e cila është një referencë gjithëpërfshirëse ku gjenden shumë tekste shkollore nga një sërë autorësh dhe botuesish, ku ndër to, biznes, shkenca kompjuterike, edukim, shkenca juridike, mjeksi dhe shkenca sociale. **Open Dissertations (Ebsco Open Dissertation) që** është një bashkëpunim midis EBSCO dhe BiblioLabs që sjell një qasje inovative për zhvillimin e kërkimit të disertacioneve doktorale ku janë të përfshirë të dhëna për disertacione dhe teza nga viti 1955 deri më sot, **Springer Link** që u siguron hulumtuesve qasje të hapur në miliona dokumente shkencore nga revista, libra, seri, protokolle, punime referuese dhe përmbledhje shkencore dhe **DOAJ** (Directory of Open Access Journals) që është bazë e pavarur e të dhënave që përmban mbi 16 500 revista, ku mbulojnë të gjitha

fushat e shkencës, teknologjisë, mjekësisë, shkencave shoqërore, arteve dhe shkencave humane. Tjetër bibliotekë shumë e cmuar, ku studentët orientohen se si të hapin llogari personale që të përfitojnë pafundësinë e informacionit, artikujve që mund të gjejnë është dhe **Harvard Business Review**. Duhet theksuar se, Universiteti Barleti është në diskutim të ngushtë me disa biblioteka dixhitale ndërkombëtare për abonime institucionale, të cilat janë të planifikuara të finalizohen së shpejti.

2. Në lidhje me rekomandimin e dytë, referuar edhe tabelës 21, Evidenca 32 - Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB, cilësia e studentëve në hyrje ka ardhur duke u rritur. Grafiku me poshtë i notës mesatare të studentëve në hyrje të programit sipas viteve e vërteton më së miri këtë faktor. Pra mund të themi që ky program e ka plotësuar këtë rekomandim të lënë nga akreditimi i mëparshëm.
   Duke filluar nga ky vit akademik, Departamenti ka rritur numrin e studentëve të ekselencës dhe ka rekrutuar studentë nga shkollat me programe dhe sukses të dokumentuar. Fituesi i çmimit në ASEDF (Albanian Science Engineering and Design Fair) është me bursë të plotë. Pjesëmarrësit në olimpiadat e fushës STEAM poashtu.




3. Në lidhje me rekomandimin e tretë, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që Universiteti Barleti ka nënshkruar me Universite të rëndësishme Europiane, stafi i Departamentit të Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike ka qenë i angazhuar në shkëmbimet ERASMUS+ për Training dhe Teaching. Pjesë e shkëmbimeve ishin Dr. Ilir Çapuni, Universiteti i Valladolid, Spanjë dhe Mp. Anisa Doçi në Universitetin South Bohemia Republika Çeke. Stafi është angazhuar në mësimdhënie, shkëmbimin e eksperiencave, vizita në Institute dhe Departamente homologe në fushën e Shkencave Kompjuterike, ku kanë ndarë eksperiencat e tyre dhe kanë krijuar ura bashkëpunimi për të ardhmen. Gjithashtu gjatë vitit 2022 në kuadër të bashkëpunimit lidhur me Projektet Ndërkombëtare dhe Zyrës Erasmus, Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike priti delegacionin spanjoll me drejtues të Shkollave të formimit Profesional dhe akademik në Spanjë si IESdeTeis, Vigo, IESELLago, Madrid dhe IESValencia.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar".

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Programi i studimit BIA kontribuon në rritjen e standardeve të fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe në përgatitjen e të rinjve me aftësi të larta për një treg që është gjithmonë e në rritje. Ky program i pajis të diplomuarit me njohuri mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme në fushën e informatikes dhe teknologjise se informacionit dhe mundëson njohje të mirë të koncepteve rreth teknologjive bashkëkohore. Programi i studimit BIA synon të kontribuojë në përmirësimin e standardeve, cilësisë dhe rritjen e vlerës së shtuar në shërbimet që ofrohen në industrinë e IT.<br><br>Programi i studimit BIA u ndërtua mbështetur:<br>- mbi kërkesat gjithnjë e në rritje të tregut teknologjik në Shqipëri, për profesionistë, specialistë dhe burime njerëzore të kualifikuara për të shërbyer cilësisht në sektorin e IT.<br>- në Strategjinë Ndërsektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" 2022 – 2026, ku synohet edukimi digjital dhe aftësitë digjitale, transformimi i të mësuarit dhe mësimdhënies.<br>Programi i studimit BIA është organizuar si program i ciklit të parë Bachelor, në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 (neni 73) dhe zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.<br>Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike, nëpërmjet programit BIA synon krijimin e një mjedisi profesional e bashkëkohor për studentët, duke krijuar kurrikula cilësore dhe punësuar si staf akademik profesionist, të aftë dhe të motivuar në përcjelljen e dijeve dhe përditësimin e studentëve me të rejat e fundit në sektorin e teknologjisë së informacionit.<br>Departamenti angazhohet fuqimisht në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, zhvillimin e veprimtarive kërkimore shkencore dhe inovative, në respektimin e lirisë së shprehjes, diversitetit dhe integritetit për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, që angazhohet në këtë program studimi.<br>Një vlerë e shtuar që ndihmon në konsolidimin e programit BIA është krijimi i një mjedisi pune, që kultivon integritetin individual dhe |

| | |
|---|---|
| | institucional në të gjitha aspektet, shkëmbimin e lirë të ideve dhe lirinë akademike.<br><br>***(Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti; Evidenca 31, SNADSh 2022-2026 Kapitulli 5.4 Synimi 4, fq. 29; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).*** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që misioni i programit të studimit ishte hartuar dhe ofruar në përputhje me misionin e institucionit, për të përgatitur studentë si profesionistë, novatorë, krijues, e sipërmarrës, të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Programi reflekton misionin dhe vizionin e institucionit, i shprehur në statutin e Universitetit Barleti.<br>Programi i studimit në ciklin e parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar", në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standarte akademike të larta, bashkëkohore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai përkrah aspiratat arsimore dhe arritjet e studentëve. Ai i nxit ata në rrisin nivelin e tyre të formimit.<br>Për të realizuar misionin e programit të studimit, departamenti kur hartoi programin e studimit, vendosi njohuri teorike dhe praktike, për të inkurajuar te studenti zhvillimin profesional, punën indivifuale dhe në ekip. Ky program jep të reja bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur nga praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>Programi i studimit BIA synon të përgatisë studentët të jenë të aftë në tregun e punës dhe ti cojë drejt një karriere të suksesshme.<br><br>***(Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti, neni 4, 5, Pyetjet gjatë vizitës në institucion).*** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UniBa ka hartuar "Strategjinë e zhvillimit institucional për periudhën 2020-2030", në konsulencë me stafin e brendshëm, drejtuesit strategjik të UniBa dhe ekspertët e jashtëm. Zbatimi i saj gjen mbështetje të plotë në programet e të gjitha cikleve që ofrohen, ku përmes shtyllës akademike si edhe asaj të kërkimit të aplikuar dhe inovacionit, synohet kryerja me efikasitet i procesit të mësimdhënies, me qëllim që studentët të pajisen me dije bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit nën udhëheqjen e një stafi akademik të përgatitur dhe cilësor.<br><br>UniBa funksionon mbështetur mbi Statutin e institucionit, dhe në Rregulloren Akademike, të cilat azhornohen në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar përshtatshmëri me zhvillimet dinamike, si të brendshme dhe të jashtme. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| | Statuti përcakton qartë drejtimet strategjike të institucionit me vision krijimin e një institucioni të arsimit të lartë cilësor si një aktor i zhvillimit, i cili ofrom vlera të vërteta profesionalizni dhe qytetarie, nëpermjet edukimin ndërdisiplinor dhe përgatitjen e individëve të angazhuar, dhe me integritet në një mjedis social aktiv.<br>Ai zhvillon aktivitetin duke respektuar lirinë akademike në procesin mësimor, kërkimor inovativ.<br>Shtyllat kryesore në Universitetin Barleti bazohen në aktivitetin akademik, përmes strukturës dhe ofertës akademike.<br>Rregullorja e institucionit përcakton drejtimet prioritare akademike përmes hartimit të rregullave kryesore të organizimit dhe funksionimit të procesit mësimor/kërkimor akademik. Rregullorja tregon qe aktiviteti i Universiteti Barleti parashikon mbeshtetje në meritat personale duke siguruar mundesi të barabarta për cdo individ. Ai është dokument themelor i veprimtarisë konkrete institucionale.<br>Këto dokumenta shërbejnë si bazë për zbatimin e programit të studimit BIA në përputhje të plotë me bazën rregullative të UniBa.<br>Organizimi dhe struktura e programit BIA është ndërtuar për 3 vite akademikë, duke krijuar lidhje mes dijeve në auditor me zhvillimet kryesore dhe kërkesat e tregut të punës.<br>Përmbajtja e programit është hartuar për të ndërtuar kompetenca profesionale te studentët, në kuadër të formit ndërdisiplinor të tyre në fushën e teknologjisë së informacionit, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin e dijeve bashkëkohore.<br><br>***(Evidenca 1.3 - Strategjia e Zhv. Instit. 2020-30 fq. 7, fq 10; Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti, neni 5,3,6 ; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, neni 2, 3, 4; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, që Universiteti Barleti ka një procedurë të përcaktuar në menaxhimin e burimeve akademike për realizimin e programit të studimit BIA. Ata kanë punësuar ekspertë dhe specialistë në fushën e teknologjisë së informacionit si personel akademik i brendshëm dhe i jashtëm.<br>GVJ duke shqyrtuar RVB, si dhe nga vizita Institucion, te zyra e Burimeve Njerzore, konstatojmë se, Universiteti Barleti, ndjek proçedura të posaçme në rekrutimin e personelit akademik efektiv (PAE) ashtu edhe me kontratë (PAK) dhe jo vetëm, të cilat janë të pasqyruara në Statut dhe në rregulloren e UniBa. Ky proçes starton me evidentimin e nevojës për punonjës nga njësia bazë e departamentit dhe zyrat e UniBa, si dhe ndjek të gjitha hallkat e brendshme derisa arrin në shpalljen e vendeve vakante dhe përzgjedhjes. Gjithashtu në bazë edhe të nevojave të institucionit, ai angazhon edhe personel me kohë të |

| | |
|---|---|
| | pjesshme. Mënyrat e konkurrimit dhe përzgjedhjes së personelit akademik si dhe nënshkrimi i kontratës së punës janë përcaktuar në Statut.<br>Institucioni prej disa vitesh tashmë është angazhuar në projekte dhe organizim trajnimesh që lidhen me fushën e teknologjisë së informacionit, gjë e cila ka pasuruar përvojën e stafit dhe institucionit me ekspertizë dhe angazhim profesional.<br><br>*(Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti, neni 50, 51)*<br>*Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, neni 48,49,50;*<br>*Evidenca 32 - Tabelat permbledhese per Aneks_RVB, Tabela 2;*<br>*Evidenca 29.1 - Infrastruktura akademike ne funksion te programit;*<br>*Evidenca 29.2 - Infrastruktura ne funksion te programit Laboratoret;*<br>*Evidenca 29.3 - Planimetria e ambjenteve FSHAK; Evidenca 10.2 - Te dhena mbi mobilitetin; Evidenca 10.3 - Marreveshje bashkepunimi brenda vendit; Evidenca 22.1 - Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale)* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit Bachelor në Informatikë e Aplikuar është i përfshirë në Departamentin e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike. Ai është një nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative. Informatika dhe shkencat kompjuterike si fushat specifike të programit janë në përputhje me të gjitha fushat bazë të departamentit.<br>Kodifikimi është realizuar plotësisht sipas përcaktimeve ligjore.<br>Programi Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" është konceptuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë.<br>Psh. programi bachelor është ndërtuar mbi synimet e programeve profesionale në informatike dhe teknologji informacioni.<br>Ai plotëson synimin për të përgatitur specialistë të zotë për tregun e punës brenda vendit dhe në rajon dhe kombinon standardet akademike me aplikimet reale.<br>Në këtë program kombinohet mësimi me kërkimin dhe krijohet një ofertë akademike që mban parasysh kërkesat e tregut.<br>Studentët përgatiten për të kontribuar për një ekonomi më të zhvilluar, shoqëri më të drejtë duke pasur këtu të integruar dimensionin ndërkombëtar.<br>Sipas Manualit të hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerës të programit të studimit, krijimi i programeve te reja dhe /ose riorganizimi i atyre ekzistuese bëhet duke respektuar parimet e përputhshmërisë me prioritetet kombëtare të arsimit të lartë, misionin e Universitetit Barleti dhe planin e zhvillimit strategjik. Midis pikave të tjera vumë re edhe parimin që të ndërtohet në përputhje me kërkesat |

| | |
|---|---|
| | e Zonës Europiane të Arsimit të lartë dhe zhvillimet e procesit të Bolonjës.<br><br>***(Evidenca 28. Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerës të programit të studimit, pika I.2; Evidenca 32 - Tabelat permbledhese per Aneks_RVB, Tabela 3)*** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi që Programi i studimit BIA kontribuon në rritjen e standardeve të fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe në përgatitjen e të rinjve me aftësi të larta për një treg që është gjithmonë e në rritje. Ky program studimi synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që hartimi i programit BIA ka kaluar në disa faza përgatitje dhe diskutimi me individë me përvojë, si me ekspertë të jashtëm të punës dhe me kompani që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e teknologjisë së informacionit.<br>Fillimisht u konceptuan programet nga departmenti pas një studimi për tregun e punës dhe nevojave të tij, por edhe duke u bazuar në përvojën e universiteteve të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë. Më pas u diskutua programit dhe shkëmbimi i ideve me ekspertë dhe akademikë të fushave përkatëse. Programi ka kaluar për shqyrtim dhe miratim në Senatin e Universitetit. Ai është ndërtuar në përputhje me strategjinë dhe objektivat e Universitetit në tërësi dhe departamentit në veçanti.<br>Me miratimin e programit nga Ministria e Arsimit, departamenti mbikëqyrur ecurinë e zbatimit të programit. Përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me anëtarët e departamentit monitorojnë dhe vlerësojnë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë ecurinë e zhvillimit të programit.<br>Në mbledhjen e departamentit pas cdo viti akademik, realizohet raporti final për ecurinë e aktivitetit të departamentit dhe të programit BIA. Aty analizohen objektivat, psh për përmirësimin e mjeteve të punës, laboratorëve, psh hapja e "laboratorit për prototipizim", ngritja e punës shkencore, etj. Nga raporti shohim që është bërë një vlerësim i punës së departamentit. |

| | |
|---|---|
| | ***(Evidenca 33.1 - Analiza dhe raporti vjetor i DSHAK 2022; Evidenca 1.6 - Rregullore DSHAK, neni 5. 9)*** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Universiteti Barleti ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione arsimore brenda vendit apo edhe institucione publike dhe grupe te ndryshëm ekonomikë që operojnë në Shqipëri apo rajon. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike ka negociuar një sërë marrëveshjesh me institucione shtetërore, si dhe biznese private në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilat janë përmbyllur me nënshkrimin e titullarëve. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve lidhet me realizimin e praktikave profesionale të studentëve që studiojnë në programin e studimit BIA, kryerja e internshipeve dhe ofrimi i mundësive për punësimin e studentëve në të ardhmen.<br>Janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private që veprojnë në fushën e TIK si: Sitel shpk, DITAK shpk, Albtelecom sha, AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), UnionBank, etj por edhe insitucione arsimore publike në vend si Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Shkodrës 'Luigj Gurakuqi" etj.<br>Universiteti Barleti është pjesë e programit Erasmus+ dhe një prej përfitimeve më të mira për studentët e Universitetit Barleti, është mundësia për të kaluar të paktën një semestër jashtë vendit me një program Erasmus+. Përveç studentëve, edhe stafi i Universitetit Barleti ka mundësinë të përfitojë nga ky program nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me këto institucione arsimore.<br>UniBa ka një gamë të gjerë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të ndryshme në Europë dhe jo vetëm.<br>Universiteti Barleti ka një strategji ndërkombëtarizimi e cila fokusohet tek studentët, stafi dhe partneritetet.<br><br>***(Evidenca 10.1 - Strategjia e nderkombetarizimit; Evidenca 10.2 - Te dhena mbi mobilitetin; Evidenca 22.1_Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale; Evidenca 10.3 - Marreveshje bashkepunimi brenda vendit)*** |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që një nga objektivat kryesore që Universiteti Barleti ka vendosur në kuadër të procesit të mësimdhënies është edhe "zhvillimi i praktikave mësimore për studentët". Praktika realizohet pranë institucioneve dhe synon të aplikojë në një kontekst praktik professional, njohuritë dhe kompetencat e marra në pjesën teorike. Institucioni i ofron mundësi studentëve të kryejnë praktikat |

| | |
|---|---|
| | profesionale në institucionet qendrore dhe lokale, në kompanitë biznese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e teknologjisë së informacionit, etj. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike ka negociuar një sërë marrëveshjesh me institucione shtetërore, si dhe biznese private në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilat janë përmbyllur me nënshkrimin e titullarëve.<br>Qëllimi i këtyre marrëveshjeve lidhet me realizimin e praktikave profesionale të studentëve që studiojnë në programin e studimit BIA, kryerja e internshipeve dhe ofrimi i mundësive për punësimin e studentëve në të ardhmen.<br><br>***(Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar, Neni 12; Evidenca 22.1_Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale; Evidenca 2.4 - Paketa e praktikes)*** |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që bashkëpunimi me kompanitë dhe institucionet në fushën e teknologjisë së informacionit, realizohet në mënyrë të vazhdueshme në departamentin ku është i përfshirë ky program. Organizohen dhe zhvillohen takime me drejtues të organizatave, institucione shtetërore, apo biznese në fushën e teknologjisë së informacionit, për të zgjeruar bashkëpunimet dhe për të shtuar përfshirjen e aktorëve të mundshëm në përmirësimin e programit. GVJ konstatoi që në fund të çdo viti akademik, hartohet nga përgjegjësi i departamentit raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimeve, si janë realizuar, dobishmëria, ndikimi i marrëveshjeve në realizimin e programit të studimit.<br>Përmes realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ka përfitim nga trajnimet, leksionet e hapura me studentët, konsulencat dhe aftësimin profesional të studentëve. Këto i ndihmojnë studentët për detyrat e kursit, projektet, për të parë tregun e punës lidhur me punësimin e tyre.<br>Qëllimi i këtyre marrëveshjeve lidhet me realizimin e praktikave profesionale të studentëve që studiojnë në programin e studimit BIA, kryerja e internshipeve dhe ofrimi i mundësive për punësimin e studentëve në të ardhmen.<br><br>***(Evidenca 22.2 - Raporti Periodik Analitik per Marreveshje Bashkepunimi)*** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi që bashkëpunimi me kompanitë dhe institucionet në fushën e teknologjisë së informacionit, realizohet në mënyrë të vazhdueshme në departamentin ku është i përfshirë ky program. Këto marrëveshje janë në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që plani mësimor i programit të studimit BIA është i organizuar në programe lëndore të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në ECTS, 60 kredite përfaqesojnë ngarkesën e punës të një viti akademik studimesh, ku një kredit ka 25 ore pune. Gjithashtu vumë re që elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë përcaktuar qartë në planin mësimor. Plani mësimor ka lëndë dhe module, ku cdo modul ka të përcaktuar kodin, tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve, ngarkesën totale në orëe, leksionet, seminaret, laboratorët, projektet. Aty tregohet ngarkesa totale në orë, dhe javore në ore e ndarë me semestra.<br>Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" bazohet si më poshtë ne ligje, VKM, statutin, si dhe udhëzime, akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërise:<br>-Ligji Nr. 80/2015 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republiken e Shqipërisë"<br>-VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre".<br>-VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".<br>- Statuti dhe Rregullorja e Universitetit Barleti.<br><br>*(Evidenca 2.1 - Plani mesimor BIA; Evidenca 3.1 - Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar)* |

| | |
|---|---|
| | |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i Studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" synon të përgatisë profesionistë me qëllim aplikimin e teknologjive bashkëkohore për zgjidhje të problemeve të ndryshme dhe menaxhimin e tyre në mënyrë strategjike dhe për të marrë vendime të qëndrueshme dhe efektive, si dhe prakticienë reflektivë që nxënë gjatë gjithë jetës. Ky programi ka objektiva të mirëpërcaktuara për formimin e studentëve me dije, aftësi dhe kompetenca për përmbushur më efektivisht rolet e ndryshme të profesionistit ne fushen e IT. Fokusi i këtij programi bazohet në zhvillimin e software-ve dhe website-ve, duke krijuar produkte te reja, website, shërbime në Internet.<br>Zhvillimin e aplikacioneve celulare duke krijuar aplikacione celulare locale dhe hibride, sherbime web. Administrimin e rrjetit kompjuterik duke eliminuar deshtimet e pajisjeve kompjuterike, etj.<br><br>***(Evidenca 2.1 - Plani mesimor BI; Evidenca 2.2 – Formati i Diplomës dhe Suplementit BIA)*** |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në planin mësimor të programit të studimit janë përcaktuar lëndët e programit të studimit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese A-E, në përputhje me Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL." me peshat e përcaktuara. Në Kategorinë A ka 30 kredite; Në Kategorinë B ka 99 kredite; Në Kategorinë C ka 24 kredite; Në Kategorinë D ka 21 kredite; Në Kategorinë E ka 6 kredite. Afërsisht 90 ECTS të programit, dmth brenda kërkesës për 50%-55% të krediteve, lidhen me disiplinën shkencore të formimit në profilin përkatës të IT. Në këtë mënyre studenti formohet në profilin e informatikës.<br><br>1.Arkitektura e Kompjuterit 6 ECTS<br>2.Bazat e të Dhënave 6 ECTS<br>3.Sisteme Informacioni 6 ECTS<br>4.Algoritmet dhe Strukturat e të Dhënave" 6 ECTS<br>5."Praktikë profesionale" 9 ECTS<br>6.Sisteme Operative 6 ECTS<br>7.Rrjeti Kompjuterik 6 ECTS<br>8.Inxhinieri Softueri 6 ECTS<br>9.Programimi mobile 6 ECTS<br>10.Bazat e Programimit 6 ECTS<br>11.Programim i Orientuar në Objekte 6 ECTS<br>12.GIS 6 ECTS<br>13. "Provë finale – Tezë përfundimtare" 6 ECTS<br><br>Një kredit ka 25 orë mësimore, përbërë nga orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra), dhe orë mësimore për |

| | |
|---|---|
| | përgatitje ose punë individuale të studentit. Po kështu neni 15 i Rregullores BIA përcakton qartë natyrën e lëndëve mësimore.<br><br>*(Evidenca 2.1 - Plani mesimor BIA; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar)* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në planin mësimor të programit të studimit BIA janë përcaktuar detyrimet përmbyllëse me 6 (gjashtë) ECTS dhe praktika mësimore me 9 (nëntë) ECTS.<br><br>*(Evidenca 2.1 - Plani mesimor BIA;* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit BIA, është organizuar dhe financohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.<br>Gjithashtu pranimi i studentëve në këtë program studimi bëhet me vendim të institucionit dhe në përputhje me standartet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të institucionit. Politikat dhe udhëzimet e MAS publikohen në fillim të çdo viti akademik.<br>UniBA eshte institucion jo public I arsimit te larte, me vetefinancim. Të ardhurat e tij parësore janë financimet e Shoqerisë Barleti Group, në të cilat përfshihen edhe të ardhurat nga tarifat e studimit dhe shërbimet e tjera të ligjshme.<br><br>*(Evidenca 2.1 – Statuti i Universitetit Barleti, neni 43; neni 46; neni 62; Evidenca 6.2-Preventiv financiar program BIA)* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | GVJ konstatoi që ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi. |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në lidhje me kodifikimin e programit të studimit priten aktet nënligjore nga ministria përgjegjëse. Plani mësimor ka lëndë dhe module, ku cdo modul ka të përcaktuar kodin, tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve, ngarkesën totale në orëe, leksionet, seminaret, laboratorët, projektet. Aty tregohet ngarkesa totale në orë, dhe javore në ore e ndarë me semestra. Po kështu aty është praktika dhe prova finale. Në planin mësimor cdo lëndë shoqërohet me kodin përkatës i shprehur në 3 gërma dhe 3 numra sipas aktit rregullator të brendshëm.<br><br>*(Evidenca 2.1 - Plani mesimor BIA)* |

| | |
|---|---|
| | |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Programi i studimit "Bachelor në Informatikë e Aplikuar" ofrohet vetëm nga Universiteti Barleti dhe nuk është në bashkëpunim me institucione të tjera. |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. GVJ konstatoi që plani mësimor i programit të studimit BIA është i organizuar në programe lëndore të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike per vitin akademik 2022-2023 përbëhet nga 12 anëtarë të Personelit Akademik Efektiv PAE, nga të cilët 4 me tituj dhe grada dhe të tjerët me Master (1 Prof. Dr; 3 Dr; 7 MSc; 1 MP). Gjithashtu 6 anëtarë jane Personel akademik me Kontrate PAK. (6 MSc).<br>Raporti personel akademik efektiv/studentë në nivel njësie kryesore është në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Ky departament e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.<br>Universiteti Barleti është akredituar institucionalisht me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 288, datë 4.09.2009 dhe me Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 9, datë 7.04.2017.<br>***(Evidenca 23 - Vendimi per hapjen e institucionit; Evidenca 24 - Vendimi per akreditimin pozitiv te Institucionit 2017; Evidenca 32 - Tabelat permbledhese per Aneks_RVB, Tabela 2)*** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative janë tre njësi bazë:<br>Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike;<br>Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit; |

| | |
|---|---|
| realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Departamenti i Industrive Kreative.<br>Vumë re që struktura dhe përbërja e njësive është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.<br>Për zhvillimin e praktikave profesionale është ngarkuar stafi i departamentit.<br>UNIBA ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme dhe organizata të biznesit për zhvillimin e praktikës.<br>Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike per vitin akademik 2022-2023 përbëhet nga 12 anëtarë të Personelit Akademik Efektiv PAE, nga të cilët 4 me tituj dhe grada dhe të tjerët me Master (1 Prof. Dr; 3 Dr; 7 MSc; 1 MP).<br>Gjithashtu 6 anëtarë janë Personel akademik me Kontrate PAK. (6 MSc).<br>UniBA nëpërmjet AM-Barleti Human Capital kultivon marrëdhënie të qëndrueshme me partnerët potencialë të industrive si akomoduesit e parë në tregun e punës të studentëve barletas. AM-Barleti Human Capital dhe UniBA kujdesen që kurrikulat, modulet e trajnimit dhe programet mësimore të ofruara të përputhen me kërkesat gjithmonë e në rritje të industrisë, biznesit dhe tregut të punës. Ekosistemi i bazuar në Helikën e pesë-fishtë (akademi, komunitet, industri/biznese, të rinj dhe organizma të ndryshme publike dhe jopublike) nxit përmirësimin e kurrikulave mësimore, kryerjen e praktikave të punës si dhe përmes bordeve të karrierës mban lidhje të që qenësishme dhe të vazhdueshme mes tregut të punës, industrive dhe jetës akademike në dobi të studentëve barletas duke ndikuar drejtëpërdrejtë në zhvillimin eknomik komunitar.<br><br>*(Evidenca 22.1_Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale; Evidenca 1.5 - Rregullore FSHAIK)*<br>**http://fshaik.umb.edu.al**<br>**https://umb.edu.al/nderveprimi-me-industrite.html** |
| | universitetit, anketime dhe pyetësorë të lidhur direkt ose indirekt me mësimdhënien. Të dhënat e mbledhura nga pyetësori online i studentëve analizohen me kujdes në të gjithë përbërësit që ndikojnë cilësinë e mësimdhënies.<br><br>Përgjegjësi i njësisë bazë, dekani i fakultetit, zv/rektori për procesin mësimor angazhohen vazhdimisht në procesin e vlerësimit të kërkesave nga studentët dhe përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. UNIBA zbaton një politikë të mirëpërcaktuar për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit, e cila parashikon si trajnimet brenda institucionit, ashtu edhe kualifikimet dhe specializimet jashtë institucionit dhe jashtë vendit. Institucioni ka mbështetur personelin akademik të përfitojë nga programet e vizitave dhe shkëmbimit të personelit me universitetet e huaja, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'u njohur me zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit. Institucioni ka mbështetur pjesmarrjen në konferenca e takime kombëtare e rajonale, përfshirjen në studime e botime si dhe projekte të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.<br><br>Studentët njoftohen në mënyrë periodike për aplikime, në programin Erasmus +, përmes email-it, në faqe web dhe gjatë leksioneve. Shkëmbehen studentë me: Universita degli Studi di Genoa, Itali Universitetin e Vico, Catalunia, Spanjë Universitetin Politeknik të Barit, Itali. Pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative e shkencore të studentëve. Stafi inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse dhe profesionin e tyre në mësimdhënie e të nxënë dhe iu krijon mundësi për mbështetje financiare në projekte kërkimore e studime të avancuara nëpërmjet instituteve UniBa.<br><br>Strukturat e pavarura që koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies janë: Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC) dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC).<br><br>KSSC - organ kolegjial i llojit komision i përhershëm i cili siguron orientim, këshillim dhe mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. KSSC<br><br>NJZHKC - njësi autonome në nivel institucioni që ka si qëllim monitorimin, vlerësimin, zhvillimin e përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së UniBa.<br>KSSC mbështet NJZHKC për të përmbushur funksionet e saj lidhur me garantimin e përmbushjes së standarteve te cilesise se institucionit dhe programeve te studimit. |

| | |
|---|---|
| | Ne fund te cdo semestri NJZHKC realizon pyetesorin studentor per cilesine e mesimdhenies.<br><br>Programi formon dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme, speciale dhe të transferueshme të cilat mundësojnë menaxhim dhe transformim të konteksteve të punës, qëndrim të pavarur, performancë të efektshme. Praktika profesionale mundëson përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional. Studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione ose në institucionin ku studentët janë të punësuar. Puna në grupe përdoret që studentë me nivele të ndryshme formimi, të gjinive të ndryshme, të diskutojnë dhe punojnë së bashku për një temë të caktuar.<br><br>***(Evidenca 1.2- Rregullorja e UniBA, neni 14; neni 15; neni 57, neni 85, 86 etj; Evidenca 1.6 - Rregullore DSHAK; Evidenca 2.6 - CV Stafi akademik; Evidenca 34.1 - Raporti Vjetor i Punes kerkimore shkencore DSHAK 2021-2022; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar, Neni 3, 18; Evidenca 10.2 - Te dhena mbi mobilitetin)*** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UniBa zbaton një politikë të mirëpërcaktuar për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit, e cila parashikon si trajnimet brenda institucionit, ashtu edhe kualifikimet dhe specializimet jashtë institucionit dhe jashtë vendit.<br><br>Institucioni ka mbështetur personelin akademik të përfitojë nga programet e vizitave dhe shkëmbimit të personelit me universitetet e huaja, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'u njohur me zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit. Institucioni ka mbështetur pjesmarrjen në konferenca e takime kombëtare e rajonale, përfshirjen në studime e botime si dhe projekte të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. Vumë re që personeli akademik realizon here pas herë leksione të hapura dhe seminare lidhur me zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë. Lidhjet e ngushta me bizneset dhe industrinë ndihmojnë për përgatitjen e këtij informacioni.<br><br>***(https://umb.edu.al/kerkimi-shkencor-i-aplikuar-dhe-novacioni.html https://umb.edu.al/news-list/2022-2023/1.html; Evidenca 34.1 - Raporti Vjetor i Punes kerkimore shkencore DSHAK 2021-2022; Evidenca 10.2 - Te dhena mbi mobilitetin)*** |
| **Konkluzione** | *Në UniBa ka struktura të pavarura që koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *mësimdhënies: Ato sigurojne orientim, këshillim mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe monitorimin, vlerësimin, zhvillimin e përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së UniBa.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që kërkesat dhe procedurat e hollësishme për provën finale përcaktohen në Paketën e Provës Finale. Kjo paketë miratohet nga Senati dhe përmban udhëzime të qarta për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të temës së diplomës. Ajo përmban edhe përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie. Për të marrë diplomën Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" studenti duhet të ketë siguruar 180 kredite si edhe të japë provën finale që mund të jetë në trajtën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, me përjashtim të studentëve me mesatare jo më të ulët se 9.5, të cilët mund të zgjedhin punim diplome. Procedura ju bëhet me dije studentëve të vitit të fundit me anë të takimeve informuese të organizuara nga Departamenti. Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga Departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për asnjë rast. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Konsiderohen shkelje të rregullave të UniBa të gjitha veprimet e kryera me dashje nga studenti, përfshirë ato që përbëjnë cënim të normave shoqërore dhe etiko-morale, si: kopjimi, plagjiatura a paraqitja si punë e vet e punës së një tjetri; dhënia ose marrja e informacionit me gojë a me shenja gjatë provimit. Ndaj studentit që kryen veprime të tilla merren masa disiplinore sipas rastit: vërejtje me shkrim, përjashtim për një vit nga UniBa përjashtim përgjithmonë nga UniBa. Gjithashtu përdoren mënyra të ndryshme për verifikimin për plagjiaturë e detyrave apo projekteve të dorëzuara nga studentët përgjatë zhvillimit të lëndës. Provimet përfundimtare bëhen të sekretuara. Sekretimi i tyre bëhet nga sekretaria. Provimet e sekretuara hapen pas korrigjimit/vlerësimit nga pedagogu ne nje seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vleresimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije |

| | |
|---|---|
| | studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e provimit përfundimtar dhe nuk mund të jetë me shumë se dhjetë vite kalendarike. Studentët që nuk paraqiten në këtë seancë vlerësimi u komunikohet nëpërmjet sekretarisë.<br>Stundenti ka te drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim pergjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga zhvillimi i provimit. Gjithashtu studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjesit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit. Fleta e vlerësimit hartohet nga Sekretaria Mësimore, nënshkruhet nga Dekani dhe Sekretaria dhe mban vulën e institucionit. Fleta e vlerësimit është standard dhe e miratuar nga Rektori mbi baze të diskutimeve me Rektoratin lidhur me elementet përmbajtës. Fleta e vlerësimit i dorëzohet komisionit të provimit ose pedagogut të lëndës ditën e provimit.<br><br>***(Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidenca 13.1 - Rregullore per testimet provimet kriteret diplomimin; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar, Neni 16; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 98, 99, 100; Evidenca 2.3 - Paketa e proves finale)*** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që kërkesat dhe procedurat e hollësishme për provën finale përcaktohen në Paketën e Provës Finale. Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" asiston dhe ndihmon studentët duke iu dhënë atyre herë pas here informacion, udhëzime për materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të provës finale. Procedura ju bëhet me dije studentëve të vitit të fundit me anë të takimeve informuese të organizuara nga Departamenti. Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga Departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për asnjë rast. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Provimet e sekretuara hapen pas korrigjimit/vlerësimit nga pedagogu ne nje seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vleresimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e provimit përfundimtar dhe nuk mund të jetë me shumë se dhjetë vite kalendarike. Studentët që nuk paraqiten në këtë seancë vlerësimi u komunikohet nëpërmjet sekretarisë.<br><br>***(Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidenca 13.1 - Rregullore per testimet provimet kriteret diplomimin; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba*** |

| | |
|---|---|
| | *Informatike e Aplikuar; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 98, 99, 100; Evidenca 2.3 - Paketa e proves finale)* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" asiston dhe ndihmon studentët duke iu dhënë atyre herë pas here informacion, udhëzime për materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të provës finale. Procedura ju bëhet me dije studentëve të vitit të fundit me anë të takimeve informuese të organizuara nga Departamenti. Personeli akademik udhëzon dhe ndihmon studentët rreth temave dhe njohurive që do të testohen në provimin final duke duke ju vënë në dispozicion informacione dhe literaturë bazë/ ndihmëse për të lehtësuar maksimalisht procesin e përgatitjes. Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga Departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për asnjë rast. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Provimet e sekretuara hapen pas korrigjimit/vlerësimit nga pedagogu ne nje seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vleresimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e provimit përfundimtar dhe nuk mund të jetë me shumë se dhjetë vite kalendarike. Studentët që nuk paraqiten në këtë seancë vlerësimi u komunikohet nëpërmjet sekretarisë.<br><br>*(Evidenca 13.1 - Rregullore per testimet provimet kriteret diplomimin; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 98, 99, 100; Evidenca 2.3 - Paketa e proves finale; Pyetjet gjatë vizitës në institucion;)* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" asiston dhe ndihmon studentët duke iu dhënë atyre herë pas here informacion, udhëzime për materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të provës finale. Procedura ju bëhet me dije studentëve të vitit të fundit me anë të takimeve informuese të organizuara nga Departamenti. Studentët i nënshtrohen provimit final ose punimit të diplomës, dhe, nga Departamenti propozohet komisioni i cili duhet të ketë jo më pak se tre anëtarë nga stafi. Udhëheqësi i diplomës caktohet nga stafi i departamentit dhe kryen orientimin e studentëve për përzgjedhjen e |

| | |
|---|---|
| | temës së diplomës. Studenti asistohet në çdo hap të procesit të punimit të diplomës nga udhëheqësi dhe udhëzohet për cdo hap të ndjekur gjatë këtij procesi nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta konsultuese apo komunikimeve elektronike. Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga Departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për asnjë rast. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Provimet e sekretuara hapen pas korrigjimit/vlerësimit nga pedagogu ne nje seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vleresimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e provimit përfundimtar dhe nuk mund të jetë me shumë se dhjetë vite kalendarike. Studentët që nuk paraqiten në këtë seancë vlerësimi u komunikohet nëpërmjet sekretarisë.<br><br>*(Evidenca 13.1 - Rregullore per testimet provimet kriteret diplomimin; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 98, 99, 100; Evidenca 2.3 - Paketa e proves finale; Pyetjet gjatë vizitës në institucion;)* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" asiston dhe ndihmon studentët duke iu dhënë atyre herë pas here informacion, udhëzime për materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të provës finale. Pedagogu udhëheqës i studentit që provën finale e ka me tezë kërkimi e asiston dhe udhëzon atë gjatë gjithë procesit të kërkimit. Ai trajton me studentin çështje të tilla si: metodologjia, përpunimi i të dhënave, paraqitja e të dhënave (diagrame, kurba etj); puna në terren, planifikimi, zbatimi, raportimi i gjetjeve/të dhënave, etj. Pedagogu udheheqës e këshillon lidhur me strukturën e diplomës, abstraktin, hyrjen, kapitujt, konkluzionet dhe rekomandimet, referencat, etj.<br>Në funksion të testimeve sipas temës shërbejnë edhe marrëveshjet me institucionet e tjera akademike apo të botës së biznesit duke i mundësuar studentëve të përdorin ambjentet e tyre për të mbledhur të dhëna sasiore ose cilësore për zhvillimin e projekteve/temave të diplomës në funksion të programit të studimit.<br><br>*(Evidenca 13.1 - Rregullore per testimet provimet kriteret diplomimin; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 98, 99, 100; Evidenca 2.3 - Paketa e proves finale; Pyetjet gjatë vizitës në institucion;)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që procedura provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës ju bëhet me dije studentëve të vitit të fundit me anë të takimeve informuese të organizuara nga Departamenti. Personeli akademik udhëzon dhe ndihmon studentët rreth temave dhe njohurive që do të testohen në provimin final duke duke ju vënë në dispozicion informacione dhe literaturë bazë/ ndihmëse për të lehtësuar maksimalisht procesin e përgatitjes. Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga Departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse.<br>Provimet e sekretuara hapen pas korrigjimit/vlerësimit nga pedagogu ne nje seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vleresimit të studentëve. Kjo seancë parashikohet dhe i bëhet me dije studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e provimit përfundimtar dhe nuk mund të jetë me shumë se dhjetë vite kalendarike. Studentët që nuk paraqiten në këtë seancë vlerësimi u komunikohet nëpërmjet sekretarisë. Mbështetur në procedurën e diplomimit dhe programin mësimor të Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" studenti në provën finale vlerësohet me notë dhe me kreditet e fituara. Studentët të cilët mbrojtjen e diplomës e realizojnë nëpërmjet provimit përfundimar, vlerësohen nga çdo anëtar i komisionit sipas lëndës që mbulon dhe vlerësimi final është mesatarja e thjeshtë e vlerësimit të antarëve të komisionit. Për studentët të cilët mbrojtjen e diplomës e realizojnë nëpërmjet një teme diplome, anëtarët e komisionit të vlerësimit mbajnë parasysh kriteret e mëposhtme për vlerësimin final të studentit: demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e temës së zgjedhur; përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumenteve të kërkimit; origjinalitetin e punimit; dobinë e punimit; cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit); paraqitjen e qartë dhe formimin e një tërësie koherente; (respektimi i kërkesave të formatit dhe kërkesave teknike); cilësinë e prezantimit etj.<br>*(Evidenca 13.1 - Rregullore për testimet provimet kriteret diplomimin; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 98, 99, 100; Evidenca 2.3 - Paketa e proves finale; Pyetjet gjatë vizitës në institucion;)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që procedura provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës ju bëhet me dije studentëve të vitit të fundit me anë të takimeve informuese të organizuara nga Departamenti. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka dhene provimin e formimit apo ka mbrojtur punimin e diplomes pajiset nga UniBa me diplomën përkatëse. Ajo plotesohet me shkrim të qartë ngjyrë blu dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UniBa-s. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada shkencore dhe titulli akademik si edhe funksioni. Modeli i diplomës është ai që është hartuar në përputhje me aktet rregulluese dhe i regjistruar pranë QSHA. Sekretaria mesimore përgatit listat e studenteve qe kane permbushur te gjitha detyrimet per pajisjen me dokumentin e diplomës dhe ia percjell per ndjekje dhe procedure Zyres se Rektorit, Zëvendesrektorit për çështjet akademike, Dekaneve dhe Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Diplomat e përgatitura ruhen ne zyren e Protokoll Arkives derisa te terhiqen nga student sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren për Funksionimin e Sekretarisë. Institucioni në përfundim të studimeve, pajis studentet me suplementin e diplomës, në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" sipas kërkesës së tij. Dorezimi i diplomave bëhet me ceremoni.<br><br>***(Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 101, 102, 103, 104, 105, 106; Evidenca 14.1 - Formati i Diplomes dhe Suplementit BIA)*** |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që te gjitha perfundimet e studentit, perfshire kreditet e akumuluara, regjistrohen ne kartelen e tij. Te drejten per ta administruar kartelen e studentit e ka vetem Sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore ruan dokumentacionin e vlerësimit për çdo modul/lëndë, regjistrat, dosjet e studentit, notat mesatare të çdo studenti etj. Kryesekretari përgatit për vendimmarrje dokumentacionin për aplikimin, regjistrimin, ndërprerjen apo rifillimin e studimeve si dhe të transferimit; është përgjegjës për plotësimin e dokumentacionit, pranimin dhe lëshimin e vërtetimeve, çertifikatave dhe dokumenteve të tjera sipas kërkesës rast pas rasti të studentëve. Procedura e ruajtjes së dokumentacionit në zyra, arkivë apo asgjësimi i tij janë të parashikuara në rregulloren e protokoll arkivës.<br><br>Të drejtën për tu njohur me kartelën e studentit, pa autorizimin e këtij të fundit e ka vetem Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 77, neni 93, etj.; Evidenca 18.2 - Rregullore e Sekretarisë mësimore; Evidenca 36 - Rregullore Protokoll + Arkive)* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi që UniBa ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. UniBa në përfundim të studimeve, pajis studentet me suplementin e diplomës. Dorezimi i diplomave bëhet me ceremoni.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Standardi IV.1**
**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | GVJ vizitoi Zyrën e Burimeve Njerëzore, kontrolloi disa dosje te rastësisme, nga ku, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë e Aplikuar, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.<br>Niveli akademik i Personelit që angazhohet në realizimin e këtij programi studimi, përputhet me modulet që ata mbulojnë brenda departamentit. Në Departamentin e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike janë të punësuar si personel efektiv 3 (tre) pedagogë me titullin Doktor i Shkencave si edhe 5 (pesë) pedagogë me titullin Master i Shkencave.<br>*[Evidenca 2.6 - CV Stafi akademik]* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Sipas legjislacionit në fuqi, personeli akademik efektiv mbulon 70% të ngarkesës mësimore. Ngarkesa mësimore e mbuluar nga personeli akademik efektiv për programin e vitit akademik 2022 - 2023 është 75%, ndërkohë që personeli akademik me kontratë mbulon 25% të programit.<br>Ky raport sipas viteve akademike ka qenë si më poshtë:<br>2019 - 2020: Ngarkesa mësimore mbuluar nga PAE:84%<br>2020 - 2021: Ngarkesa mësimore mbuluar nga PAE:77%<br>2021 - 2022: Ngarkesa mësimore mbuluar nga PAE:70% |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Nga sa më sipër, GVJ konsaton se Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike dëshmon një qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar për të gjithë periudhën e akreditimit.<br>GVJ vizitoi Zyrën e Burimeve Njerëzore, u panë disa kontratat dhe vërehet që gjithë personeli, kryhen të gjithë deklarimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | UniBa ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Zyra e Burimeve Njerëzore e UniBa është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekturimit.<br>GVJ vizitoi Zyrën e Burimeve Njerëzore, u panë disa kontrata dhe vërehet që procedura e rekrutimit të një pedagogu/e është:<br>1-Shpallje online e kërkesës për vend pune për pedagog me kritret përkatëse.<br><br>2-Aplikimi on-line i të interesuarve.<br><br>3-Intervistë me një komision me përfaqësi nga departamenit, Zyra e burimeve njerëzore, dekanati dhe rekroti akademik.<br><br>4-Demonstrim i aftësive mësimdhënëse para një ekipi pedagogësh.<br><br>5-Vendimmarja përfundimtare.<br><br>6-Nënshkrimi i kontratës konform kërkessave ligjroe për periudhën e proves.<br><br>Vërehet gjithashtu që kuadri rregullativ i UNIBA përmban procedura transparente të rekrutimit dhe te vlerësimit të personelit.<br>Zyra e Burimeve Njerëzore vepron bazuar në manualin e menaxhimit të burimeve njerëzore.<br>Ngrihet një komision intervistimi që ka në përbërjen drejtuesin e ZBNJ, zv.Rektor, Dekan, përgjegjës departamenti, drejtues të Zyrës së Performancës etj duke siguruar kështu që kandidatëtët të plotësojnë kushtet dhe të jenë në nivelin e duhur të kualifikimeve në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kriteret e përcaktuara në dokumentin e politikës së rekrutimit të ZBNJ rekrutojnë personel konform kritereve të Ligjit të Arsimit të lartë.<br><br>*[Evidenca 7.1 - Manuali i Menaxhimit te HR]* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e | Nga vizita GVJ në Institucion, një pjesë e mirë e lëndëve zhvillohen në laboratorët e dedikuar për këtë program mësimor. UniBa ka në strukturën e tij drejtori specifike të cilat merren me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e kësaj infrastrukture që është në funksion të programit të studimit. |

| | |
|---|---|
| mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | *[ Evidenca 29.1 - Infrastruktura akademike ne funksion te programit]*<br>*[Evidenca 29.2 - Infrastruktura ne funksion te programit Laboratoret]* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Zyra e Burimeve Njerëzore e UniBa ka një bazë të dhënash (dosje personale aplikimi dhe punësimi, formularë vlerësimi, tabela statistikore) për të gjithë personelin. Zyra e Burimeve Njerëzore kujdeset që për cdo vit akademik të rifreskohet CV e pedagogëve, ku të pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku ai/ajo merr pjesë. GVJ vizitoi dhe Zyrën e Performancës në UniBa e cila disponon raportimet semestrale të secilit pedagog/e për veprimtarinë e tij/të saj mësimdhënëse, kërkimore dhe angazhime të tjera administrative dhe në projekte kërkimore, aplikative. Departamenti disponon ngarkesën mësimore të secilit pedagog/e për secilin semestër, si dhe oraret mësimore për pedagogët, bashkë me programet lëndore ku pedagogu/ja është titullar/e apo lektor/e e lëndës. Po ashtu, Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të dhënat për stafin ndihmës dhe atë administrativ, të dhëna këto të cilat ruhen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Departamenti ka dhe një koordinator të emëruar me anë të një urdhri të brendshëm. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UniBa ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në nivel institucional me institucione të tjera të arsimit të lartë apo organizata të tjera për të rritur në këtë mënyrë mundësitë për studentët e tij për kryerjen e praktikave profesionale apo punimit të diplomës. Përzgjedhja kryhet bazuar mbi fushën e ekspertizës së personelit akademik si edhe ideve për zhvillim të këtyre praktikave apo diplomës të vetë studentëve.<br><br>*[Evidenca 10.3 - Marreveshje bashkepunimi brenda vendit]*<br>*[Evidenca 22.1 - Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale]* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Nga Vizita në Departament, procesi i praktikës profesionale nëpër institucionet pritëse zhvillohet sipas udhëzimeve të përcaktuara në Paketën e Praktikës, ku është personeli mbikqyrës i ambjentit pritës i cili monitoron ecurinë e zhvillimit të kësaj praktike si edhe ndihmon studentin në përmbushjen e raportit përfundimtar që dorëzohet dhe vlerësohet më pas nga stafi akademik përkatës.<br><br>*[Evidenca 2.4 - Paketa e praktikes]* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton që personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit BIA, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ vizitoi Universitetin Barleti. Ai zotëron të gjithë kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies, praktikës profesionale, trajnimeve dhe çdo nevojë apo kërkese tjetër të studentëve në lidhje me ambjentin. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Institucioni ka ambjent të përshtatshëm për praktikat mësimore si dhe ambjent të pershtatshëm rekreacioni dhe pushimi. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur me dritare që hapen dhe mbyllen si dhe sistem mbrojtje nga zjarri por edhe ajër të kondicionuar. Ambjentet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t`ju përgjigjur edhe qëndrimit me orë të zgjatura në leksione dhe seminare të studentëve.<br>UniBa ushtron aktivitetin në dy kampuse (3 godina). Kampusi 1 ndodhet në Rrugën e Kosovarëve dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 3,805 m2 dhe me sipërfaqe të shfrytëzueshme 2,347 m2, ndërsa Kampusi 2 ndodhet në Rrugën Frang Bardhi dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 2,933 m2 dhe me sipërfaqe të shfrytëzueshme 6,451 m2. Hapësirat janë të ndara në klasa leksioni/seminari, laboratorë, zyra për stafin, biblioteka, mjedise sportive dhe mbështetëse.<br><br>*[Evidenca 29.1 - Infrastruktura akademike ne funksion te programit]*<br>*[Evidenca 29.2 - Infrastruktura ne funksion te programit Laboratoret]*<br>*[Evidenca 29.3 - Planimetria e ambjenteve FSHAK]* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | GVJ vizitoi ambjentet ne UniBa. Çdo klasë ka kompjuter dhe videoprojektor funksional dhe akses të përhershëm interneti. Çdo auditor sipas lëndës apo modulit të zhvilluar është i pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital, tabelë për të shkruar si dhe të gjitha mjetet e nevojshme ndihmëse kancelarike si blloqe, stilolapsa, lapustila etj. UniBa ka disa klasa edhe me mjedise të dedikuara për inovacion dhe nxitje të ideve sipërmarrëse dhe kreative si Cooëorking space. Gjithashtu ka disa laboratorë kompjuterash të përshtatura sipas fushës dhe profilit të praktikës të cilët ndër të tjera kanë parametrat e |

| | |
|---|---|
| | duhur teknologjikë edhe për ushtrimin cilësor të mësimdhënies në distancë. Në të njëjtën kohë UniBa disponon edhe bibliotekë fizike dhe digjitale, me akses si për studentët ashtu edhe për pedagogët e cila ofron dhe mjedisin e duhur e të qetë për të lexuar.<br><br>*[Evidenca 29.2 - Infrastruktura ne funksion te programit Laboratoret]* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | UniBa për lëndët dhe programet e IT ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike ku janë instaluar sisteme operative si Ëindoës Server 2019, Ëindoës 10, Ubuntu, Linux OS Ubuntu 18.04, CENTOS 6 dhe Ëindoës 7; Softëare: IntelliJ, Visual Studio Code, VirtualBox, Ëireshark, Cisco Packet Tracer, Notepad++, MySQL server, MySQL ëorkbench, Adobe Photoshop, Adobe Dreamëeaver, PhpStorm,, paketa e plotë XAMPP ( Apache + MariaDB + PHP + Perl). Janë krijuar të gjitha ambientet e laboratorit të informatikës, ambiente për ofrimin e kurseve të eficencës së energjisë, vlerësimit të pasurive të paluajtshme, interior design, restaurime.<br><br>*[Evidenca 35.1 - Udhezues TIK]* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Ne funsion te programit të studimit, GVJ konstaton se, UniBa ka gjithë infrastrukturën e nevojshme në shërbim të studentëve. Institucioni ka në përdorim 3 laboratorë informatike për qëllime mësimore nga të cilët 2 prej tyre janë në dispozicion të studentëve të programit Bachelor"Informatikë e Aplikuar", të cilët janë të pajisur me pajisjet e nevojshme për praktikat e kësaj fushe. Përkatësisht:<br><br>**LAB 1- 032**: Përmban 30 + 1 kompjutera dhe 1 video projektor,<br><br>Kompjuterat në këtë sallë janë të markës Lenovo me procesor i5 gen 4, me memorie 8 GB, me disk SSD me kapacitet 256 GB dhe me monitorë 22 inçësh.<br><br>**LAB 2 - 035**: Përmban 24 + 1 kompjutera + 1 video projektor, Kompjuterat në këtë sallë janë të markës Lenovo me procesor i7 gen 7, me memorie 16 GB, me disk SSD me kapacitet 256 GB dhe HDD 1TB , GPU 2GB te detikuar dhe me monitorë 24 inçësh.<br><br>**LAB 3 - 036**: Përmban 30 + 1 kompjutera + 1 video projektor. Kompjuterat në këtë sallë janë të markës Fujitsu me procesor i7 gen 6, me memorie 16 GB, me disk SSD me kapacitet 256 GB, GPU GTX 4GB e detikuar dhe me monitorë 22 inçësh.<br><br>Gjithashtu laboratorët, studiot, apo mjediset e tjera për programin e studimit përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të |

| | |
|---|---|
| | përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.<br><br>*[Evidenca 29.2 - Infrastruktura ne funksion te programit Laboratoret]* |
| **Konkluzione** | *UniBa vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë te përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin praktik të programit BIA. GVJ konstaton se UniBa ka gjithë infrastrukturën e nevojshme në shërbim të studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Në UniBa, ka një literaturë bazë dhe ndihmëse që garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të duhura për të përgatitur specialistë të teknologjisë së informacionit. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj literature ndodhet në bibliotekën e UniBa-s në hapësirën e dedikuar fushës së teknologjisë së informacionit në mënyrë që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave.<br>GVJ vizitoi bibliotekën e UniBa, e cila është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Totali i titujve në bibliotekën e universitetit është rreth 4.250 tituj.<br><br>*[Evidenca 30 - Biblioteka ne funksion te programit]* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Në UniBa punohet për Pasurimin periodik të fondit të bibliotekës, sikurse dhe shtimi i aksesit në bibliotekat online.<br>Në fillim të çdo viti akademik, secili departament propozon një listë të përditësuar me libra që duhet t'i shtohen fondit të biblotekës fizike dhe asaj online të nevojshëm për zhvillimin e programit mësimor. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | GVJ gjatë vizitës ne Bibliotekën e Universitetit Barleti konsaton se, Bibloteka është e konceptuar në hapësira të ndryshme të universitetit me qëllim shërbimin dhe ofrimin e librit sa më pranë studentit.<br>Njësia qëndrore e bibliotekës ndodhet në katin e 1-rë me një hapsirë 27.3 m2 me 18 poste leximi dhe 5 poste kompjuterike. Nga kjo njësi bazë biblioteka zgjerohet në një tjetër hapësirë prej 95.1 m2 ku janë të arkivuara revistat shkencore, punimet e konferencave, periodikët e |

| | |
|---|---|
| | fushave të ndryshme dhe 50 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare.<br>Më tej, biblioteka zgjerohet në katin përdhe me një hapsirë 70 m2 dhe me 27 poste leximi si dhe poste me kompjutera për aksesimin në bibliotekat dixhitale.<br><br>*[Evidenca 30 - Biblioteka ne funksion te programit]*<br>*[Evidenca 35.7 - ANEKS 8 - Platforma Biblioteka Online]* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e UniBa është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.<br><br>*[Evidenca 30 - Biblioteka ne funksion te programit]* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ vizitoi të gjitha ambjentet e sallave, dhe vëren se UniBa i krijon kushtet studentëve për të aksesuar një sërë bibliotekash online si: biblioteka digjitale EconBiz me të cilën Universiteti Barleti ka marrëveshje bashkëpunimi, që ofron orientim dhe ndihmë në kërkimin e artikujve, punimeve dhe librave digjital si dhe akses të plotë dhe të licensuar në internet. Në fushën e studime europiane ofron rreth 96,847 artikuj; biblioteka digjitale JSTOR, siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore në 75 disiplina. Të tjera burime janë, OpenDissertations.org (Ebsco Open Dissertation) që është një bashkëpunim midis EBSCO dhe BiblioLabs që shërben për zhvillimin e kërkimit të disertacioneve doktorale ku janë të përfshirë të dhëna për disertacione dhe teza nga viti 1955 deri më sot, si dhe DOAJ (Directory of Open Access Journals) që është bazë e pavarur e të dhënave që përmban mbi 16 500 revista, ku mbulojnë të gjitha fushat e shkencës, teknologjisë, mjekësisë, shkencave shoqërore, arteve dhe shkencave humane.<br><br>*[Evidenca 30 - Biblioteka ne funksion te programit]* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Menaxhimi i librave të bibliotekës në UniBa bëhet nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit[1] ku mundësohet menaxhimi i librave sipas kategorive të ndryshme, kontrollimi me lehtësi për lëshimin/kthimin, vonesave, humbjes apo dëmtimin e librave. Platforma ofron të gjitha opsionet e nevojshme për anëtarët në mënyrë që procesi i kërkesave drejtuar bibliotekës të jetë sa më i lehtë. duke klikuar në "Kliko këtu për katalogun online" mund të bëjë |

| | |
|---|---|
| | kërkimin e librit, mund të rezervojnë ose në mungesë mund të bëjnë kërkesë për rezervimin e librit sapo të kthehet në bibliotekë. I gjithë ky proces ndiqet dhe menaxhohet lehtësisht nga stafi i bibliotekës përmes postës elektronike.<br><br>[1] https://biblioteka.umb.edu.al/ |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Në të gjithë ambjentet e sallave të Bibliotekës, kohëzgjatjen e orarit të saj është ajo e orarit zyrtar të punës së institucionit. Në orarin 08.30 - 16.30 stafi akademik, studentët, si dhe stafi jo mësimdhënës mund të bejmë kërksë dhe të shërbehen me libra. Ndërmjet ores 16.30 – 19.45 ambjentet e bibliotekës mund të përdoren për studim/lexim.<br>Por nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit[1] mund të bëhet kërkimi i titujve të librave që ndodhën në bibliotekë, kërkimi i librave elektronikë dhe punimet e diplomave, edhe kur studentët dhe stafi nuk janë fizikisht në ambjentet e universitetit.<br><br>[1].https://umb.edu.al/biblioteka.html |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Departamentet në UniBa bashkëpunojnë ngushtësisht me përgjegjësen e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Nga takimi me studentët i grupit GVJ, ata ndjehen të plotësuar dhe të të inkurajuar që të marrin një libër më shpesh në duar, apo për të diskutuar rreth sfidave të librit në epokën moderne, librit përballë digjitalizmit, librit dhe teknologjisë. Në këtë Universitet është krijuar dhe klubi Books and Tech, i cili ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e interesit rreth librave në një botë që ndryshon me ritme të shpejta teknologjike. |
| **Konkluzione** | *Mësimdhënia në Programin BIA mbështetet nga mjediset e bibliotekës së UniBa , e cila është e pajisur me tekste mësimore, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe të huaja, fizike dhe online, të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha veprimtarive mësimore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UniBa disponon një sistem të plotë menaxhimi administrativ, ku bëjnë pjesë njësitë e organikës së brendshme si: sekretaria mësimore, zyra e rekrutimit dhe pranimit, dekanati i studentëve, klubet studentore si dhe të gjithë stafi administrativ dhe akademik, i cili ofron në vazhdimësi, informacion të rëndësishëm e të vlefshëm për studentët dhe i mbështet ata profesionalisht në çdo hap të formimit të tyre akademik, social dhe studentor.<br>Ky zinxhir mbështe studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.<br>Ekzistojnë platforma e menaxhimit te studenteve siç është ajo e portalit studentor, platforma LMS e Classroom. Portali studentor është një sistem në përdorim nga studentët ju mundëson atyre të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike, informacion mbi lektorët dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Sistemi i brendshëm i menaxhimit përbëhet nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, Sekretaria e Përgjithshme dhe Sekretaritë Mësimore, Bordet e Karrierës Pranë Departamenteve, Zyra e Matjes dhe Vlerësimit të Performancës si dhe Zyra e Menaxhimit të Logjistikës dhe Operacioneve.<br>Këto njësi me anë të kooperimit në kuadër të funksioneve, detyrave dhe përgjegjësive funksionale dhe organike dhe ndërveprimit me njera tjetren, realizojnë suksesshëm të gjitha proceset, aktivitetet dhe veprimtaritë e domosdoshme të administrimit efiçent të institucionit.<br>Ky sistem rregullon dhe sistemon veprimtarinë e proceseve të tillë si: përgatitja dhe monitorimi i orareve mësimore, kontratat e punës, formularët e matjes dhe vlerësimit të performancës, formularët dhe programi i ngarkesës mësimore, formulari i evidentimit të masave disiplinore dhe aplikimit për leje vjetore, raporte leje lindje etj.<br>Gjithashtu, sistemi për komunikimin e brendshëm përfshin komunikimin online me platformat e vëna ne dispozicion si edhe me anë të INTRANETIT të monitoruar nën domain të universitetit dhe komunikimi me publikun nëpërmjet site zyrtar, mediave sociale, etj.<br><br>GVJ mendon se sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmësakademik, si dhe partnerëve të angazhuar për realizimin e programit.<br><br>*[Evidenca 35.1 - Udhezues TIK]* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi i menaxhimit i ofron të gjithë personelit akademik dhe administrativ si dhe studentëve të vet, të gjithë informacionin e kërkuar dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas statusit, pozicionit, interesit dhe qëllimit të kërkesës. Ky akses sigurohet nëpërmjet të drejtave në |

| | |
|---|---|
| | sistem të gjithsecilit, të përcaktuara këto sipas pozicioneve të punës apo funskionit në UniBa, nëpërmjet kredencialeve të personalizuara.<br><br>Po ashtu edhe studentët kanë të drejtë të marrin vërtetim të ndjekjes së studimeve, listë notash, aksesojnë në sistem për të parë notën e tyre të provimit, apo të informohen në çdo kohë mbi ecurinë dhe gjendjen e situacionit të pagesave të tyre vjetore.<br><br>*[Evidenca 35.1 - Udhezues TIK]* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Nga takimet e GVJ ne Universitet, shihet që sistemi i menaxhimit ka te zgjidhur pjesën e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit të brendshëm. Kjo realizohet me anë të sistemit elektronik të komunikimit me anë të emaileve në grup me domain-in **umb.edu.al,** me anë të klasave në Google Classroom sipas lëndëve, grupeve, viteve dhe programeve të studimit, me anë të komunikimit në Google Meet si dhe me anë të grupeve në rrjete sociale dhe në platformat dhe aplikacionet e komunikimit.<br>Ky komunikim realizohet edhe në kontaktet individuale të personalizuara të pedagogut dhe studentëve, sekretarisë apo koordinatorëve të programeve me studentët, në verbalisht në auditor, takime, seminare dhe ëorkshope si dhe në cel, email, rrjete sociale apo në çdo formë tjetër që lidhet me komunikimin ndërpersonal. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Monitorimi aktivitetit akademik dhe administrativ realizohet në disa forma dhe menyra. Monitorimi realizohet me anë të evidencave nga sistemi elektronik i hyrjes dhe daljes në institucion si dhe largimit dhe kthimit të përkohshëm në të, me anë të një njoftimi rast pas rasti mbi arsyen e shkëputjes. Monitorimi gjithashtu realizohet nga raportet mujore të angazhimit të personelit akademik dhe administrativ drejt titullarit direkt, burimeve njerëzore dhe zyrës së performancës. Monitorimi po ashtu realizohet edhe me anë të produktit final konform afateve të përcaktuara të detyrave të ngarkuara. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Vërehet që, faqet zyrtare të internetit të institucionit janë të plotësuara në kohë reale dhe rifreskohen disa herë në ditë duke mbajtur të përditësuar të gjithë informacionin e duhur mbi programet e studimit, organizimin, aktivitetet e ndryshme të intitucionit dhe bio mbi personelin akademik në shqip dhe anglisht. Ky përditësim bëhet në Rrjetet Sociale: Facebook, Instagram, Youtube, Tëitter:, si dhe në ëeb: (**ëëë.umb.edu.al**<br><br>**https://fshaik.umb.edu.al/departamenti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-kompjuterike.html** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html)** | | | |
| **Konkluzione** | *Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

**Standardi IV.5**
**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ vizitoi zyrën e financës ne UniBa. U shtyrtuan raporete financiare, çdo vit. Në UniBa hartohet një raport financiar i detajuar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij. Gjithashtu, financa ka një fond rezervë emergjence në të gjitha rastet për moscënim të mbarëvajtjes së studimit për një cikël të plotë studimi.<br>GVJ mendon se në UniBa ka stabilitet financiar dhe kryhet nje monitorim I kujdesshëm rigoroz e I detajuar duke ndërhyre dhe korrigjuar kur është e nevojshme raportin të ardhura dhe shpenzime.<br><br>*(Evidenca 6.2 – Preventiv financiar programi BIA)* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | GVJ mendon se, UniBa i përmban të gjitha pikat e planit të financimit të një programi studimi dhe administron me përgjegjshmëri dhe korrektësi të lartë të gjithë hallkat e planit të financimit, jo vetëm në përmbushje të ecurisë konkrete të mbarëvajtjes së institucionit dhe programit të studimit por duke përmbushur në kohë të gjitha detyrimet kontraktuale nga marrëveshje dhe kontrata me të tretë.<br>Institucioni për të garantuar ecurinë e programit të studimit, administron të ardhura që vijnë kryesisht nga: Konsulencat dhe shërbimet, Tarifat për dhe gjatë shkollimit, Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm), e të tjera (qera, ndryshime kursi valutor, interesa bankare).<br><br>*(Evidenca 6.2 - Preventiv financiar programi BIA)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Në UniBa kryhen 2 lloje kontroll auditimi, i brendshëm i jashtëm.<br><br>1. Kontrolli dhe Auditimi i brendshëm: |

| | |
|---|---|
| | Bëhet në përputhje me aktet e brendshme të institucionit. Në përfundim të procesit të Auditimit të Brendshëm, hartohet raporti paraprak i cili i dërgohet Administratorit brenda dy javëve pas përfundimit të punës audituese. Pas kësaj audituesit synojnë të bien dakord për raportin paraprak me menaxhimin e Institucionit – përfshi këtu edhe plan-veprimin – dhe përfundimin e raportit final brenda dy javëve pas dërgimit të raportit paraprak tek drejtuesit përkatës. Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm i dërgohet menaxhimit të Universitetit.<br><br>2. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm :<br><br>Kryhet nga auditues të përzgjedhur nga ministria . Auditimi i Jashtëm, duke filluar nga viti 2017 auditohen rregullisht çdo vit nga kompania audituese "Grant Thornton" e cila është një kompani auditimi e njohur ndërkombëtarisht. Kjo kompani çertifikon pasqyrat financiare të institucionit që paraqiten për palët e treta dhe organet shtetërore. Raportet e Auditimit të Jashtëm depozitohen në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe janë lehtësisht të disponueshme për të gjitha palët e interesuara.<br><br>GVJ mendon se Kontrolli dhe auditimi ne UniBa mbështetet në kërkesat ligjore të ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.<br>***(Evidenca 6.4 - Auditimi i brendshem; Evidenca 6.5 - Auditimi i jashtem)*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Në UniBa zbatimi i politikave financiare bëhet nga Zyra e Financës, e cila është përgjegjëse për respektimin e parimeve dhe rregullave të kontabilitetit në përputhje me aktet ligjore. UniBa mban në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet. Pasqyrat Financiare hartohen të qarta për përdorues të jashtëm dhe sigurojnë besueshmëri, në to nuk ka gabime dhe respektohen parimet e besnikërisë, të përmbajtjes ekonomike ligjore, paanshmërisë duke dhënë pamje të vërtetë të pasqyrave financiare, të qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë parashikuar edhe në aktet ligjore. Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, UniBa, në zbatim të ligjit, ka ndërtuar e vendosur sistemin e politikave të procedurave, veprimtarive dhe kontrolleve. Çdo vit treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit bëhen pjesë e analizës në bordin e Administrimit.<br><br>***(Evidenca 6.6 - Raporti financiar vjetor)*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit | Nga vizita GVJ në UniBa, rezulton se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitetet financiare të duhura për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Raporti |

| | |
|---|---|
| të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | i auditimit financiar evidenton përdorimin e të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët.<br><br>***(Evidenca 6.1 - Deshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare; Evidenca 6.3 - Burimet Financiare te UniBa; Evidenca 6.6 - Raporti financiar vjeto)*** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UniBa, garanton qëndrueshmëri financiare, kapacitet financiar për perballimin dhe përmirësimin e situatës financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit. Raporti i auditimit financiar evidenton përdorimin e të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Procesi nga pranimi i studentëve deri në diplominim e tyre mbështetet në: legjislacionin në fuqi , statutin e institucionit, rregulloren akademike UniBA, rregulloren e programit të studimit, burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse.<br>GVJ konsaton se, Universiteti Barleti ka një strukturë të mirë organizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje që drejtohen nga Zv. Rektori për Çështjet Studentore i cili drejton punën e disa zyrave si: Zyrën e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Dekanin e Studentëve dhe vet-organizimi studentor dhe Zyrën e Alumnit dhe Karrierës. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej zyrave përshkruhen në rregulloren e UniBa-s.<br><br>***(Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa)*** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Në këtë Institucion, kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë, duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për kandidatët dhe studentët e programeve të studimit. Kjo sanksionohet dhe në rregulloren e institucionit, rregulloren e programit, manualin e bursave e të gjithë aktet e tjera rregullatore të UniBa-s.<br><br>*(Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti. Kreu VI; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Kreu IX; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar, Kreu VI)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Grupi Vleresimit Jashtëm vëren se kriteret, procedurat e pranimit[1] të përzgjedhjes së studentëve, si dhe kërkesat e tyre për transferim[2] janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të Universitetit[3], si edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të Institucionit dhe në aktet rregulloratore të UniBa-s.<br><br>*(Evidenca 18.5 - Kriteret e pranimit)*<br><br>[1] http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html<br><br>[2] http://umb.edu.al/transferohu.html<br><br>[3] http://umb.edu.al/pranimet.html |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Sic dhe u theksua më lart, GVJ mendon se procesi i pranimit, kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe të përzgjedhjes së studentëve, si dhe kërkesat për transferim janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të ëeb të Universitetit, edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të Institucionit dhe në aktet rregulloratore të UniBa-s.<br><br>(https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html) |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Politikat e përgjithshme dhe ato të veçanta të pranimit të studentëve në programin e studimit hartohen çdo vit përpara fillimit të vitit akademik dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në portalin U-Albania. UniBa përditëson sipas udhëzimeve dhe V.K.M-ve përkatëse portalin U-Albaina në sesionin "Kriteret e Pranimit" i cili është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Gjithashtu ky informacion vihet në dispozicion në faqen zyrtare të Universitetit, sesioni "Pranimet" .<br>Kriteret e pranimit të studentëve në çdo program studimi propozohen nga departamenti dhe miratohen me vendim Senati. Konkretisht, |

| | |
|---|---|
| | kriteret e pranimit për programin e studimit BIA publikohen në linkun e mëposhtëm dhe janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit:<br><br>https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.<br>Gjithashtu, edhe këto kritere , për të gjithë të interesuarit, janë të aksesueshme në faqen zyrtare të web të Universitetit:<br><br>https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Nga dokumentacioni i shqyrtuar nga GVJ , kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të pranimit në programin e studimit, janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi.<br>Regjistrimi i studentëve shqiptarë nga trojet dhe të studentëve të huaj bëhet mbështetur në ushëzimet e MASR dhe çdo vit UniBa parashikon kuotat të veçanta për regjistrimin e shqiptarëve nga trojet. Për këtë kategori studentësh, UniBa nuk parashikon kritere shtesë, përpos atyre që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.<br>***[Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar, Neni 24, 25]*** |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | UniBa bën publike llojet e bursave të ofruara prej saj. UniBa nën drejtimin e Administratorit nëpërmjet akteve të brendshme organizon komisione ad hoc me qëllim, për shqyrtimin e aplikimeve për bursa. Miratimi përfundimtar i tyre bëhet nga Bordi i Administrimit. UniBa rezervon të drejtën për të ofruar bursa të ndryshme studimi, të plota ose të pjesshme, bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet e brendshme normative dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.<br>Miratimi përfundimtar i tyre bëhet nga Bordi i Administrimit.<br><br>***(Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 84; Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 84)*** |
| **Konkluzione** | *UniBa harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. GVJ mendon se procesi i pranimit, kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe të përzgjedhjes së studentëve, si dhe kërkesat për transferim janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi V.2<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | GVJ konsatton se, në rregulloren e programit të studimit janë parashikuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin akademik. Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve, komunikimi i vlerësimeve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kritere dhe procedura të vlerësimit, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve etj.<br>Përmes koordinatores së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët informohen në detaje lidhur me secilën prej procedurave të parashikuara. Ata mund të informohen për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik, për numrin e krediteve të akumuluara për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, etj.<br>Në javën e parë të pranimit në UniBa, gjatë javës së akomodimit, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet në funksion të tyre.<br><br>***(Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar)*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ pati takim me studentët, të cilët ishin të informuar në mënyrë te detajuar në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. UniBa pranon transferime të studentëve nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë. E gjithë procedura e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimit parashikohet në Rregulloren e Transferimeve, Rregullore e Programit të Studimit dhe në Manualin Rekrutim-Aplikim-Rregjistrim- Transferim, kreu VII.<br>***(Evidenca 18.3 - Rregullore transferimi; Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar; Evidenca 18.1 - Manual aplikim rekrutim regjistrim transferim)*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" janë përcaktuar kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve. Këtu janë parashikuar procedurat lidhur me kriteret dhe procedura të vlerësimit, e drejta për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimeve dhe dokumentimi i vlerësimeve. Studentët, në takim me GVJ, pohuan se ishin të mirëinformuar për format e vlerësimit të dijeve, syllabusin e lëndës, kriteret e vlerësimit etj.<br><br>***(Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar)*** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Sipas programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar" prova finale zhvillohet në trajtën e provimit të formimit dhe me punim diplome. Studentët me mesatare mbi 9.5 mund të përgatisin punim diplome.<br>Në Bibloteken e Insitucionit, GVJ shikoi programin e provimit të formimit, i cili përmban çështjet kryesore të të gjitha lëndëve të planit mësimor, por dhe databazë të pyetjeve të programit që lidhen me kompetencat e domosdoshme profesionale të fituara.<br>Dokumentacioni për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, i cili, në UniBa njihet si Paketa e Provës Finale, cilëson të gjithë procedurat e provës finale dhe të temës së diplomës. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen.<br>Deri tani në këtë program studimi nuk ka patur studentë të diplomuar me punim diplome.<br><br>***(Evidenca 3.1 - Rregullore Ba Informatike e Aplikuar)*** |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Nga takimi i GVJ me drejtues te Institucionit, konfirmohet se, UniBa zbaton një politikë të organizuar rekrutimi të studentëve të ardhshëm duke u mbështetur në një plan vjetor aktivitetesh dhe në strategjitë e rekrutimit dhe marketingut. Aty përfshihen konferenca me maturantët, konferenca me mësuesit e karrierës nëpër gjimnaze dhe jo vetëm, eskursion tour të maturantëve në ambjentet e institucionit, vizita të stafit të UniBa në shkollat e mesme duke prezantuar me detaje kriteret e pranimit në secilin program studimi, konkurset, bursat, etj. Të gjitha këto informacione gjenden edhe në web site të UniBa në sektorin e Pranimit.Po ashtu, në fillim të vitit të ri akademik, UniBa zhvillon Javën e Orientimit, ku studentët prezantohen me ambjentet, stafin akademik dhe atë mbështetës.<br><br>***(Evidenca 39 - Strategjia e Marketingut)*** |
| **Konkluzione** | *UniBa vë në dispozicion të studentëve të programit BIA, informacion të hollësishëm mbi përparimin akademik, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomim. Në fillim të vitit të ri akademik, UniBa zhvillon Javën e Orientimit, ku studentët prezantohen me ambjentet, stafin akademik dhe atë mbështetës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Nga takimi GVJ me studentët, ata dëshmojne se janë të informuar në mënyrë të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programin e studimit në kohë dhe forma të ndryshme, si p.sh.:<br>1. Në mjediset e UniBa, gjatë ditëve të pritjes me maturantët ku organizohen takimeve informuese, sqaruese dhe orientuese në lidhje me programin e studimit;<br>2. Gjatë periudhës së regjistrimit dhe gjatë javës së parë të akomodimit, në të cilën Dekani i Fakultetit apo përgjegjësi i Departamentit dhe personeli akademik bëjnë prezantimin e programit të studimit;<br>3. Gjatë viteve të studimeve, koordinatori i departamentit jep orientime të nevojshme dhe të vazhdueshme për organizimin e programit të studimit.<br>Ne vërejmë se në hollin e institucionit janë të ekspozuara materiale informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuese, si: fletëpalosje, postera, broshura etj., si dhe materiale audio-vizive, si: spote televizive, mesazhe promocionale, etj;<br>Të dhëna të detajuara për programin e studimit gjenden edhe në faqen e internetit, në hapësirën virtuale dedikuar këtij departamenti.<br>**https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html**<br>Nëpërmjet rrjetit të gjerë të shërbimeve studentore, studentët janë të organizuar në Klubet Studentore Barleti, ku kanë një jetë aktive që ndërthurin projektet dhe aktivitetet e iniciuara nga pedagogët, nga departamentet, si dhe nga vetë studentët.<br>**http://students.umb.edu.al/klubet-studentore.html** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Sic u theksua dhe më lart, studentët e programit të studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar", që në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë studimit të tyre marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogëve të secilit modul. Nga taimi GVJ me studentët , ata pohojnë se , në fillim të çdo semestri atyre u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës programi lëndor (syllabuset), në të cilin janë specifikuar temat për çdo javë mësimore, shoqëruar me literaturën e detajuar me faqe, por edhe format e vlerësimit.<br>Gjatë pandemisë, nisur dhe nga situata e diktuar nga pandemia programet lëndore si dhe materialet për zhvillimin e leksioneve dhe |

| | |
|---|---|
| | seminareve për secilin modul i gjejmë të publikuar edhe në sistemin online, platformën Google Classroom.<br><br>***[Evidenca 2.5 - Syllabuse]***<br>***[Evidenca 37 - Manual i mesimdhenies online]*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Nga marrëveshja Bashkëpunimit për praktikën profesionale, si dhe nga takimet GVJ në Zyrën e "Alumnit dhe Karrierës", UniBa ka punuar ngushtësisht me punëdhënës dhe partnerë të ndryshëm dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me ta. Janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private si etj. Në UniBa janë ngritur dhe funksionojnë Bordet e Karrierës, ku bëjnë pjesë ekspertë dhe profesionistë të fushës.<br>Po ashtu, Dekani i Studentëve dhe drejtuesi i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës përmes takimeve të ndryshme me studentë ofrojnë ndihmëse në qartësimin e programit të studimit dhe mënyrën se si studentët mund të orientojnë studimet e tyre drejt një punësimi të suksesshëm.<br>GVJ konsatton se Zyra e "Alumnit dhe Karrierës" në bashkëpunim me njësitë e tjera të Grupit Barleti (Barleti Human Capital etj.) zhvillojnë rregulisht aktivitete dhe trajnime për të afruar studentët me tregun e punës.<br><br>***[Evidenca 22.1 - Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale]*** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Ka një bashkëpunim mes Koordinatorit të Departamentit, Dekanit të Studentëve dhe Sekretarisë Mësimore në funksion të realizimit të procesit mësimor. Ato mbajnë kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programin e studimit, nëpërmjet komunikimeve elektronike dhe portalit studentor.<br>Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve nëpërmjet email-it zyrtar nga sekretaria mësimore. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UniBa, u dërgohet nga Koordinatori i Departamentit dhe Dekani i Studentëve. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Sic pohojnë dhe studentët, në fillim të çdo semestri ata njihen me të gjithë programet lëndore (syllabuset), ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. Ky informacion publikohet edhe në platformën Google Classroom, ku çdo student sheh gjithë materialet sipas javëve dhe temave përkatëse.<br>Studentët zotërojnë adresa personale të postës elektronike me domain @umb.edu.al. Përmes portalit studentor, studentët mund të gjejnë online rezultatet e tyre të provimeve. |

| | |
|---|---|
| | GVJ pohon se studentëve u mundësohet një Informacion i detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave, krediteve, etj. mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i publikuar në faqen e web të UniBa.<br><br>https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html<br>***[Evidenca 35.1 - Udhezues TIK]***<br>***[Evidenca 35.6 - ANEKS 5 - Manual perdorimi Portali Studentor Admin]*** |
| **Konkluzione** | *UniBa vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit BIA, rezultatet dhe mundësitë e punësimit. GVJ pohon se studentëve u mundësohet një Informacion i detajuar në lidhje me programin, lëndët, kreditet, etj. Kjo mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i publikuar në faqen e web të UniBa.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **[illegible]** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | GVJ vizitoi Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e "Alumnit dhe Karrierës'' nga ku mësojmë se disponohen të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në çdo vit akademik në programin e studimit Bachelor në "Informatikë e Aplikuar", si dhe për numrin e të diplomuarve.<br>***[Evidenca 32 - Tabelat permbledhese per Aneks_RVB, Tabela 21]*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Institucioni disponon një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar", studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër si edhe ata që janë çregjistruar. GVJ konfirmon se ky informacion gjendet pranë Sekretarisë Mësimore |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të | Si dhe më lart, të dhënat e studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore nëpërmjet përdorimit të sistemit të brendshëm të informacionit. Gjithashtu në funksion të studentëve është portali studentor, platformë ku pasqyrohen të dhënat mbi: notat dhe rezultatet e provimeve, data e zhvillimit të provimit, etj, Portali studentor u |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| verifikueshme nga personat e autorizuar. | mundëson të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta. Sekretaria mësimore përpunon këto të dhëna për Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit sipas kërkesës.<br><br>**https://studentportal.umb.edu.al/**<br>***[Evidenca 35.1 - Udhezues TIK]***<br>***[Evidenca 35.6 - ANEKS 5 - Manual perdorimi Portali Studentor Admin]*** | | | |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Në Sekretarinë Mësimore cdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat për ecurinë e studimeve dhe rekordet e studentit. Dosjet e aplikantit verifikohen nga komisioni i ngritur nga Departamenti.<br>Të dhënat e studentëve menaxhohen nëpërmjet përdorimit të infrastrukturës informatike, të përshtatur poëer mbajtjen e të dhënave. Gjithashtu në funksion të studentëve është edhe portali studentor, platformë ku gjenden të dhënat mbi notat dhe lëndët e dhëna provim.<br>**https://studentportal.umb.edu.al/** | | | |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Në çdo vit akademik institucioni realizon një raport analitik, kur prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Ky informacion përdoret për të bërë analizën vjetore të institucionit dhe paraqitet në raportin vjetor. Gjithashtu këto të dhëna janë pjesë e analizës vjetore të punës së njësive bazë për ecurinë e programeve të studimit.<br>Nga vizitat e GVJ në Departament dhe në Zyrën Alumni dhe Karriera, vërehet një komunikim dhe bashkëpunim me të diplomuarit, lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim.<br>***[Evidenca 32 - Tabelat permbledhese per Aneks_RVB, Tabela 21, 23]***<br>***[Evidenca 33.1 - Analiza dhe raporti vjetor i DSHAK 2022]*** | | | |
| **Konkluzione** | *UniBa mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit BIA, nga pranimi deri në diplomim, dhe të dhëna të punësimit. GVJ vizitoi Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e "Alumnit dhe Karrierës" ku ka të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në çdo vit akademik dhe për numrin e të diplomuarve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Nga dokumentat e vëna në dispozicion GVJ-së, në Universitetin "Barleti", parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organe vendimmarrëse, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre. Ndër strukturat kryesore të përfshirjes së studentëve përmendim:<br>• Senatin Akademik;<br>• Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta;<br>• Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë;<br>• Dekanatin e Fakultetit;<br>• Këshillin/qeverinë e studentëve;<br>• Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj të hapura për studentët.<br>***[Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti]***<br>***[Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa]***<br>***[Evidenca 20.1- Politika të mbështetjes, përkrahjes]***<br>***[Evidenca 20.2 - Rregullore Qeveria Studentore]***<br>***[Evidenca 20.5- Strategji e Klubeve Studentore 2020-2025]***<br>***[Evidenca 20.4 - Manual i Klubeve Studentore 2022]*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Në UniBa studentët përfshihen edhe në forma dhe mënyra të ndryshme në vlerësimin e procesit akademik. Nga dokumentacioni dhe vizita GVJ në Zyren e Njësi-së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë , dy herë në vit bëhet sondazh, mblidhen të dhëna për secilën lëndë dhe secilin pedagog dhe të gjithë studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset mësimore dhe jo vetëm.<br>Njëkohësisht studentët përfaqësohen me një anëtar në grupin e punës për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm. Një student i këtij programi është përfshirë në këtë RVB.<br>***[Evidenca 8.2 - Instrumenta vleresimi, Pyetesori per studentet]*** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Grupi GVJ shqytoi një pyetsor, nga ku vërehet përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.<br>Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, kryen anketime dy javë përpara mbarimit të çdo semestri, në të gjitha programet e studimit, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Nga të dhënat e mbledhura nga anketimi dalin sugjerime për përmirësimin e programit të studimit. Rezultatet e |

| | |
|---|---|
| | pyetësorëve përdorën nga njësitë bazë dhe kryesore si edhe nga pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar procesin e mësimdhënies.<br><br>*[Evidenca 8.2 - Instrumenta vleresimi, Pyetesori per studentet]* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | GVJ mendon se mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve në UniBa është një proces transparent, i cili pasqyrohet në rregullore, sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë.<br><br>Dhënia e argumenteve për vlerësimin e studentëve nga pedagogu i secilës lëndë, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues i vëmendjes që UniBa ka ndaj transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit.<br><br>*[Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, Neni 88].* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se në UniBa studentët angazhohen në organe vendimmarrëse, këshilluese, për përmirësimin e programit BIA, metodave të mësimdhënies, etj. Grupi GVJ shqytoi një pyetsor, nga ku vërehet përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Koordinatori i Departamentit janë njësitë e posaçme të ngritura në UniBa me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve.<br>Këto njësi ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore.<br><br>*[Evidenca 18.2 - Rregullore e Sekretarisë mësimore]*<br>*[Evidenca 20.3- Rregullore e zyrave studentore]* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të | Nga takimi i GVJ me studentët, ato pohojnë se mund t'i drejtohen Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.<br>Gjithashtu ata mund t'i drejtohen Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së "Alumnit dhe Karrierës", për të marrë informacion dhe këshillim për |

| | |
|---|---|
| bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | aktivitete e shërbime mbështetëse brenda e jashtë UniBa dhe për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore.<br><br>*(Evidenca 20.3- Rregullore e zyrave studentore)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Gjithashtu sic u tha dhe me lart, studentët pohojnë se marrin shërbim mbështetës për të planifikuar karrierën e tyre nga njësitë e shërbimeve studentore, Dekani i Studentëve dhe Zyra "Alumni dhe Karriera", të cilat bashkëpununojnë në mënyrë të vazhdueshme me departamentet, për të lehtësuar dhe ndihmuar studentët për shërbimin e këshillimit të karrierës GVJ në takim me studentët, konsaton se ata janë të orientuar për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale. Gjithashtu janë te mbështetur nga koordinatori i departamentit dhe pedagogu për të mbikëqyrur lëndën e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor të këtij programi studimi.<br>Një ndër klubet studentore që organizon studentët dhe zhvillon aktivitete lidhur me zhvillimin e karrierës është edhe Klubi i Karrierës. Ky klub organizon një seri aktivitetesh në dobi dhe në ndihmë të studentëve, me fokus zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive individuale dhe profesionale të tyre, për t'u bërë konkurues në tregun e punës.<br><br>**https://students.umb.edu.al/klubet-studentore.html**<br><br>**[Evidenca 20.3- Rregullore e zyrave studentore]**<br>**[Evidenca 1.2 - Rregullorja e UniBa, shtyllat e aktiviteteve kryesore në UniBa]** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ vizitoi Zyrën "Alumni dhe Karriera". Kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve jo vetëm në UniBa por edhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mail, kontaktit me telefon, pyetsorëve, adresave të rrjeteve sociale, etj.<br>Çdo vit, zyra "Alumni dhe Karriera" harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit dhe sipas kërkesës ua vë ato në dispozicion organeve përkatëse.<br><br>Po ashtu në UniBa, nëpërmjet zyrës së Alumni dhe Karrierës organizohen edhe aktivitete, ku Alumni ndër vite mblidhen për të ndarë historitë e tyre të suksesit, si një mënyrë për forcuar lidhjet, por edhe për shkëmbyer informacione për tregun e punës midis alumni dhe Barletasve aktualë.<br><br>*(Evidenca 20.3- Rregullore e zyrave studentore, Neni 9)*<br><br>Linku i pyetesorit alumni:<br><br>**https://docs.google.com/forms/d/1ruA3zdzmClqcAmsELYYIfKOFvb2a8rMHv_0TppP100A/edit** |

| Konkluzione | *UniBa ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e problematikave, etj. GVJ vizitoi Zyrën "Alumni dhe Karriera" e cila mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve jo vetëm në UniBa por edhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Në UniBa janë hartuar një sërë dokumentash për garantimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat janë:<br>❖ Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë,<br>❖ Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë,<br>❖ Udhëzues për metodat e mësimdhënies,<br>❖ Manuali i hartimit të kurrikulave,<br>❖ Udhëzuesi për shkrimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, etj.<br><br>Gjithashtu gjatë pandemisë së Covid 19 dhe kur u kalua në mësimdhën online, janë hartuar një sërë udhëzimesh dhe manualesh për t'i ardhur në ndihmë departamenteve gjatë zhvillimit të mësimdhënies online, si Manuali i mësimdhënies online, Guide instruktive e mesimit On-line, Udhëzues për provimet në google forms, etj.<br>GVJ mendon se UniBa ndjek një politikë dhe procedura të qarta për implementimin e proceseve të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies.<br><br>*( Evidenca 17.3 - Rregullore e Komisionit te SC; Evidenca 17.1 - Rregullore e NjZhKC; Evidenca 11.1 - Udhëzues për metodat e mësimdhënies; Evidenca 16.1 - Manuali i* |

| | |
|---|---|
| | *Hartimit.Riorganizimit.mbylljes dhe vleres. te prog. Studimit; Evidenca 37 - Manual i mesimdhenies online)* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Në UniBa, GVJ bëri vizitë ne njësitë bazë e kryesore që bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën e tyre për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmësakademik. Këto struktura janë: Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, Zëvendës Rektori për Çështjet Akademike, Zyra e Vlerësimit të Performancës<br><br>Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe zyra e Vlerësimit të Performancës, në mënyrë të vazhdueshme monitorojnë procesin e mësimdhënies nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga stafi akademik, nga njësitë bazë e kryesore, nga studentët, nga stafi administrativ dhe mbi bazën e tyre gjykohet për nevojën për përmirësim të proceseve mësimore por edhe atyre administrative.<br><br>*(Evidenca 8.2 - Instrumenta vleresimi)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Në takim me studentët, ata pohojnë se jane pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Mendimet e tyre i shprehin nëpërmjet pyetësorëve që realizohen 2 herë në vit në përfundim të çdo semestri. Këtu kanë mundësi të vlerësojnë lëndën, metodat e mësimdhënies që përdor pedagogu, mënyrën e transmetimit të dijeve, literaturën, etj. Në përfundim hartohet raporti i vlerësimit të studentëve i cili me rekomandimin e rektorit të institucionit i dërgohet departamenteve.<br><br>*[Evidenca 12.2 - Raport mbi vleresimin e studenteve ]* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, që janë Komisioni i sigurimit të standardeve të cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të studentëve në web site:<br><br>*https://umb.edu.al/dossier-uniba.html* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | GVJ pohon se institucioni përdor metodologji vlerësimi, për ecurinë dhe mbarëvajtjen e mësimdhënies. Këtu përfshihen:<br>- vetë-raportime nga pedagogët në lidhje me mësimdhënien në lëndët përkatëse;<br>- analiza e punës së departamentit;<br>- monitorim nga njësia e zhvillimit kurrikular dhe cilësisë.<br>Databaza e krijuar nga përgjigjet është e disponueshme për njësitë akademike bazë dhe kryesore, sekretarinë mësimore, rektoratin dhe |

| | |
|---|---|
| | krijon mundësi për të vlerësuar ecurinë e organizimit të procesit mësimor por edhe përmirësimit të vazhdueshëm.<br>Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë si edhe drejtuesi i departamentit bëjnë edhe monitorime të dokumentacionit që i përçohet studentëve nëpërmjet Google Classroom. Procedurat e monitorimit përshkruhen në manualin e mësimdhënies online në linkun e raportimit:<br><br>*https:*//docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfKMiutv9c8xIFVrO32uIXSO6fSg-ËLstPn4C6BKGy_in3mPg/viwww.form<br><br>*[Evidenca 37 - Manual i mesimdhenies online]* |
| **Konkluzione** | *Në UniBa Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe zyra e Vlerësimit të Performancës, në mënyrë të vazhdueshme monitorojnë procesin e mësimdhënies nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga stafi akademik, nga njësitë bazë e kryesore, nga studentët, nga stafi administrativ dhe mbi bazën e tyre gjykohet për nevojën për përmirësim të proceseve mësimore por edhe atyre administrative.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Është lehtësisht e verifikueshme se në UniBa, Struktura Organizative është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë Nr. 80/2015 si për nga organizimi, ashtu edhe nga ndarja e detyrave të cilat janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në statutin e institucionit, rregulloren e UniBa dhe në aktet e tjera rregullatorë. Strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë:<br><br>• Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë;<br>• Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë.<br><br>Të dy këto struktura kanë dhe aktet e tyre rregullatore si: Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Organizimi dhe funksionet e tyre janë të parashikuara edhe në Statutin e institucionit neni 10 dhe 28, rregulloren e UniBa neni 14 dhe 15. |
| | Gjithashtu në nivel institucional është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i cili ka në fokus jo vetëm performancën e stafit akademik të UniBa-s (neni 15), por dhe vlerësimin e procesit akademik, kërkimor, sektorit të çështjeve |

| | |
|---|---|
| | studentore, vlerësimin e marrëdhënieve me komunitetin, vlerësimin e procesit të administrimit dhe zhvillimit institucional, etj.<br>*[ Evidenca 17.3 - Rregullore e Komisionit te SC]*<br>*[Evidenca 17.1 - Rregullore e NjZhKC]*<br>*[Evidenca 12.1 - Rregullore Vlerësimi&Administrimi Performance]*<br>**https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Nga takimet e GVJ në Institucion, konsatohet se Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Menaxhimit dhe Administrimit të Performancës, Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, Zyrën e Pranimeve, Dekanin e studentëve, njësitë bazë e kryesore, studentët, alumni e bashkëpunëtorë të tjerë të jashtëm.<br><br>Në strategjinë UniBa 2020-2030 janë parashikuar objektiva konkretë dhe të matshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë së proceseve akademike si p.sh:<br><br>• Mësimdhënia dhe të nxënët sipas modeleve të kombinuar "online'' dhe ''ballë për ballë"<br>• Punësimi i të diplomuarve<br>• Të nxënët gjatë gjithë jetës<br>• Përmirësimi i kurrikulave pasurimi i bibliotekës<br>• Mirëfunksionimi i strukturave të menaxhimit dhe organizimit në UniBA<br>• Ndërkombëtarizimi etj.<br><br>Përmbushja e secilit prej objektivave është parashikuar të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë mes strukturave të brendshme dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të UniBa.<br><br>Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të Performancës gjithashtu jep sugjerime dhe rekomandime në funksion të përmirësimit të kulturës së cilësisë në Institucion. Rekomandimet e komisionit përmblidhen në udhëzime të rektorit për zbatim.<br><br>*[ Evidenca 1.3 - Strategjia e Zhv. Instit. 2020-30]*<br>*[Evidenca 11.4 - Udhezime Rektori]* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë | Universiteti "Barleti" ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit që përbëhet nga: formular vlerësimi i studentëve për lëndën në formën e pyetësorëve anonimë, formular mbi transparencën e vlerësimit, formulari i vlerësimit kolegë me kolegë, si dhe raporte të vlerësimit të studentëve për pedagogët, lëndën dhe programin. |

| | |
|---|---|
| e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UniBa i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>Raporte të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit gjenden në intranet, dhe publikohen në faqen ëeb të UniBa:<br><br>**https://umb.edu.al/dossier-uniba.html**<br><br>***[Evidenca 8.2 - Instrumenta vleresimi]*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | GVJ vizitoi zyrën e Burimeve Njerëzore, ku në mënyrë periodike, çdo anëtar i stafit me kohë të plotë raporton mbi angazhimin e tij gjatë semestrit. Ky raportim përfshin disa aspekte: angazhimin nëmësimdhënie, trajnime, projekte, puna kërkimore, punë administrative. Bazuar në këtë vetdeklarim, por edhe në dokumentat përkatës të departamentit, përgjegjësi i departamentit bën vlerësimin për secilin anëtar të stafit.<br>Krahas vetëdeklarimit, të dhënat që lidhen me angazhimin në mësimdhënie merren edhe nga sekretaria, si orët e realizuara në raport me orët e planifikuara, apo raportime që bën sekretaria në lidhje me mbarëvajtjen e mësimit, provimeve etj. Në varësi të rezultateve, bazuar edhe në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Institucioni merr vendimet përkatëse, si emërimin në pozicione të caktuara, mbulimin e një pjese të shpenzimeve për konferenca apo aktivitete të tjera kërkimore.<br>Këto bëhen pjesë dhe e diskutimeve në mbledhjet e departamentit, pasqyrohen dhe në dokumentin e raportit të punës vjetore të Institucionit.<br>***[Evidenca 11.3 - Formular i Punes Semestrale]***<br>***[Evidenca 7.1 - Manuali i Menaxhimit te HR]*** |
| **Konkluzione** | *UniBa ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë së programit të studimit BIA që përbëhet nga: formular vlerësimi i studentëve për lëndën në formën e pyetësorëve anonimë, formular mbi transparencën e vlerësimit, formulari i vlerësimit kolegë me kolegë, si dhe raporte të vlerësimit të studentëve për pedagogët, lëndën dhe programin.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi VI.3**
**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| --- | --- |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | GVJ pohon se në UniBa ekzistojnë një sërë procedurash e mekanizmash formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të programeve të studimeve të ciklit të parë.<br>Propozimi për hapjen e programeve të studimit apo riorganizimin e tyre vjen nga njësitë bazë që do të ofrojnë programin e studimit. Përgatitja për hapjen e programeve të reja bëhet nga një grup pune i ngritur enkas për këtë proces dhe në përputhje me strategjinë afatmesme e afatgjatë të UniBa-s, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi.<br>UniBa nëpërmjet njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, vë në dispozicion Manualin e Kurrikulës dhe orienton njësite bazë për hapjen e programeve të studimit apo riorganizimin e atyre ekzistuese. Ndryshimi i programeve të studimit dhe vlerësimi periodik i tyre bëhet me qëllim evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e ndryshimit dhe ndjekjen e praktikave dhe arritjeve më të mira për të përmirësuar programet e studimit.<br><br>Rezultatet e vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve vendimmarrëse në disa mënyra. Nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë ka një raportim në nivel institucional për procese të ndryshme monitorimi. Ndërkohë edhe nga departamenti bëhen raportime lidhur me ecurinë e procesit të mësimdhënies dhe akademik pranë autoriteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse.<br>***[Evidenca 12.2 - Raport mbi vleresimin e studenteve]***<br>***[Evidenca 33.1 - Analiza dhe raporti vjetor i DSHAK 2022]*** |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Në të gjitha njësitë e UniBa, diskutohen raportet e vlerësimit të brendshëm, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Mbështetur në të dhënat e paraqitura në raportet e vlerësimit hartohen planet vjetore të punës së njësive bazë, hartohen urdhra e vendime në nivel institucional që orientojnë njësitë bazë e kryesore lidhur me zhvillimin e kulturës së cilësisë në institucion.<br>***[Evidenca 11.4 - Udhezime Rektori]***<br>***[Evidenca 11.5 - Udhezime Rektori Ngarkesa e stafit]*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, | Ne takim me stafin, dhe vizitat ne institucion të GVJ-së, konsatohet se në kuadër të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit në këtë Institucion përdoren instrumenta si:<br>• Vet raportimi nga pedagogu për punën semestrale<br>• Raportim narrativ i pedagogëve pranë departamentit<br>• Vlerësim i studentëve nëpërmjet formularëve që bëhen me studentët çdo fund semestri nga NJZHKC |

| | |
|---|---|
| testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | • Mbledhje mujore në department për ecurinë e procesit mësimor.<br>• Raportim përmbledhës nga drejtuesi i njësisë bazë për ecurinë mujore të programit të studimit<br>• Raportime nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë;<br>• Vlerësim paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi/a i departamentit.<br><br>*[Evidenca 11.3 - Formular i Punes Semestrale]*<br>*[Evidenca 8.2 - Instrumenta vleresimi]*<br>*[Evidenca 12.3 - Pyetesor i stafit akademik dhe ndihmes akademik]*<br>*[Evidenca 11.6 - Dosja e pedagogut mesimdhenia online]* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Si dhe me lart, në institucion përdoren metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e ecurisë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve si:<br><br>• Monitorim të procesit të mësimdhënies<br>• Vlerësim nga studentët për çdo lëndë në formën e pyetësorëve<br>• Fokus Grupe<br>• Rezultatet e studentëve në provime<br>• Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup )<br>• Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës<br>• Rezultate të punimit të diplomave.<br>GVJ vizitoi Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, të cilat realizojnë studime periodike të punësimit të studentëve dhe kanë një databazë të studentëve të punësuar.<br>Pedagogët e jashtëm që janë edhe ekspertë të fushës gjithashtu raportojnë për ecurinë e procesit mësimor dhe ofrojnë ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.<br><br>Anëtarët e bordit të karrierës dhe ekspertë të tjerë të fushës, bashkëpunëtorë të departamentit ftohen në takime e diskutime rreth përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. |
| **Konkluzione** | *UniBa monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit BIA, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ vizitoi Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, të cilat realizojnë studime periodike të punësimit të studentëve dhe kanë një databazë të studentëve të punësuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi VI.4<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Institucioni garanton sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.<br>Në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është parashikuar që të ketë një përfaqësues nga studentët e sanksionuar kjo, edhe ne në nenin 4 të rregullores për funksionimin e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të cilësisë.<br>Nga takimi me studentët, GVJ pohon se në organe vendimmarrëse përfshirja e mendimit të studentëve është e garantuar. Gjithashtu studentët dhe sekretaria mësimore janë pjesë e grupit të vlerësimit të brendshëm të çdo programi studimi.<br>Ekspertët e jashtëm janë bashkëpunëtorët më të ngushtë të njësive bazë, për ofrimin e programeve të studimit në përputhje me standardet dhe kriteret e cilësisë.<br>*[Evidenca 17.3 - Rregullore e Komisionit te SC]*<br>*[Evidenca 20.1- Politika të mbështetjes, përkrahjes]* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Nga takimet në Institucion, mësohet se anëtarët përbërës të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë.<br>Detyrat e tyre specifikohen përgjithësisht në Rregulloren e UniBa-s, Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë dhe Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë si edhe në planet e punës të këtyre njësive. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Sic dhe vihet re në raportin GVB , anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studim it janë:<br>• pedagogë pjesë e njësisë bazë që ofron programin,<br>• personel administrativ,<br>• studentë të programit.<br>Metodologjia e hartimit të RVB në hyrje të këtij raporti përshkruan përfshirjen e të gjithë aktorëve në këtë proces. GVJ konstaton se i gjithë procesi është transparent si për njësinë bazë dhe atë kryesore. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve. |

| | |
|---|---|
| | Gjithashtu në Statutin e UniBa-s, neni 3, pika 3 thuhet se ''veprimtaria e uniBa me studentët dhe personeli mbështetet në meritat personale dhe përjashton cdo lloj diskriminimi''.<br><br>*[Evidenca 1.7 - Kodi i Etikes]*<br>*[Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti]* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Grupi GVJ konsaton se pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm, pedagogë me kohë të pjesshme, përfaqësues të institucioneve partnere, ish student alumni.<br><br>Mendimet dhe ekspertiza e tyre vjen nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve etj. |
| **Konkluzione** | *UniBa përfshin personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit. Grupi GVJ konsaton se pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë pedagogë, studentë, administratë, edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm, pedagogë me kohë të pjesshme, përfaqësues të institucioneve partnere, ish student alumni, etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Politikat, strategjitë, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të Cilësisë për programet në UniBa, janë transparente dhe publikohen edhe në faqen e website në lidhje me Sigurimin e Cilësisë por edhe në faqen zyrtare të institucionit.<br><br>**https://umb.edu.al/nwwws4901.html**<br><br>**https://umb.edu.al/nwwws5125.html**<br><br>**https://umb.edu.al/nwwws5030.html**<br><br>**https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html** |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ konsaton se në UniBa, parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Këto parime sigurojnë garantimin e transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UniBa, njësive të tij, programeve, |

| | |
|---|---|
| | kurrikulave, shërbimeve etj. Të gjithë raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit gjenden në faqen web të UniBa. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Në bazë të rezultateve të dala nga vlerësimi që bëhet në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, njësitë bazë dhe kryesore, angazhohen (me vendim të Rektorit) për të iniciuar adresimin e përmirësimeve dhe mangësive të evidentuara. *[Evidenca 11.4 - Udhezime Rektori]* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi, programet e studimit përmirësohen deri në masën 20% , nëpërmjet pasurimit të literaturës bazë dhe mbështetëse, pasurimin dhe plotësimin e materialeve, temave mësimore si edhe nëpërmjet ndryshimeve profilizuese të programit të studimit. Si rregull, ndryshimet e tilla profilizuese të programit të studimit mund të bëhen vetëm një herë nga njëri akreditim në tjetrin,. GVJ konsatton se UniBa i jep një rëndësi shumë të vecantë procesit të akreditimit. Ky institucion e konsideron një proces me rëndësi që ndihmon fuqishëm për marrjen e vendimeve për të bërë ndryshime profilizuese të programit të studimit, për disa arsye:<br>Së pari, vlerësimi i brendshëm tërësor i programit të studimit, gjithashtu nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit;<br>Së dyti, vlerësimi i jashtëm i programit të studimit nga ekspertë dhe rekomandimet e bëra prej tyre, mund të nxjerrin në pah nevojën për përmirësime të programit të studimit;<br>Së treti, akreditimi i programit realizohet pas ofrimit, për një periudhë të caktuar kohe, kur mësimdhënia është konsoliduar, rezultatet e studentëve kanë dalë disa herë dhe nevojat për përmirësim janë më të bazuara.<br>Njësia bazë dhe kryesore, mbështetur në informacionet e mbledhura mund të kërkojë ndryshim pas një cikli të plotë të programit të studimit: në fund të tre viteve për programet Bachelor, në fund të vitit për programet Master Profesional me 60 ECTS, në fund të dy viteve për programet Master Shkencor me 120 ECTS, pas akreditimit të tyre dhe si rregull vetëm njëherë nga një akreditim në tjetrin. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Nga vizita në Zyren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë vërejme se ketu organizohen veprimtari periodike me personelin dhe me studentet për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.<br>**https://umb.edu.al/nwwws4901.html**<br>**https://umb.edu.al/nwwws5125.html**<br>**https://umb.edu.al/nwwws5030.html** |
| **Konkluzione** | *Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente, efektive. Nga vizita në* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Zyren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë GVJ vëren se ne UniBA organizohen veprimtari periodike me personelin dhe me studentet për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë e Aplikuar"" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Barleti"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

- Programi Bachelor "Informatikë e Aplikuar" ka një vizion të mirë përcaktuar, mision dhe plan të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, bashkëkohor.
- Programi Bachelor "Informatikë e Aplikuar" garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuara.
- Programi është ndërtuar në përputhje me nevojat e tregut.
- Laboratorët e informatikës janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor apo praktikave.
- UniBa ka bashkëpunim me institucione homologe, institucione, ndërmarrje me të cilat realizon objektivat për kërkimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe punësimin e të diplomuarve.
- UniBa ofron mundësi për stafin akademik dhe për studentët për shkëmbime e programe mobiliteti me institucione akademike në Europë.
- UniBa ka një strukture të kompletuar të njësive koordinuese dhe sigurimit të cilësisë.
- Të diplomuarit janë punësuar në sektorin publik dhe privat, në përputhje me fushën e tyre.
- Programi i studimit respekton standardet akademike. Plani mësimor, syllabuset metodat e mësimdhënies e mësimnxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike.
- Ka pjesëmarrje të studentëve në disa projekte, ku disa janë të ideuara nga studentët.
- Programi garanton konkurrimin me sukses të diplomuarve në tregun e punës.
- Personeli akademik është me grada dhe tituj dhe eksperiencë në fushat përkatëse.
- UniBa ka infrastrukturë moderne dhe funksionale.

**Pika të dobta:**

- Angazhim jo i të gjithë anëtarëve të departamentit në kërkimin shkencor.

**Rekomandime:**

- Stafi akademik të vazhdojë procesin e marrjes se gradave dhe promovimeve për titujt akademikë.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Applied Informatics" provided by the Higher Education Institution "Barleti University".**

**Strengths and Affirmations:**

- The Bachelor program in "Applied Informatics" has a well-defined vision, mission and clear, complete, contemporary strategic development plan.
- The Bachelor program in "Applied Informatics" guarantees the preparation of students in accordance with the defined objectives.
- The program is built in accordance with the needs of the market.
- Informatics laboratories are equipped with all the necessary infrastructure for the realization of the learning process or practices.
- UniBa has cooperation with counterpart institutions, other institutions, enterprises with which it realizes the objectives for research, exchange of experiences and employment of graduates.
- UniBa offers opportunities for academic staff and students for exchanges and mobility programs with academic institutions in Europe.
- UniBa has a good structure of coordination and quality assurance units.
- Graduates are employed in the public and private sector, in accordance with their field.
- The study program respects academic standards. The teaching plan, syllabuses, teaching and learning methods are according to the requirements of the academic standards.
- There is student participation in several projects, some of which are student-initiated.
- The program guarantees successful competition of graduates in the labor market.
- The academic staff has degrees and titles and experience in the relevant fields.
- UniBa has modern and functional infrastructure.

**Weaknesses:**

- Commitment of not all members of the department to scientific research.

**Recommendation:**

- Academic staff to continue the process of obtaining degrees and promotions for academic titles.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |